

Procesverbal

*Nga Mbledhja X (e dhjetë) e rregullt e Kuvendit të Komunës së Dragashit, e mbajtur më datë:
29.10.2024*

Rend Dite

- 1) Miratimi i Raportit të Shpenzimeve për periudhën Janar-Shtator 2024;
- 2) Miratimi i Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2024-2028; dhe
- 3) Eventuale.

Arijeta Skeraj: Përshëndetje, kryetar! Përshëndetje për të gjithë asambleistët! Përshëndetje drejtorë, përfaqësues nga OSBE-ja, media dhe të gjithë të pranishmit që ndodheni në sallë! Mirë se keni ardhë në seancën e dhjetë të rregullt (e njëmbëdhjeta me radhë) për vitin 2024! Besoj që materialin e keni pranuar të gjithë. Në këtë seancë kemi tri pika të rendit të ditës, siç e keni pranuar ftesën. Para se ta qesim në votim, a do dikush me e marrë fjalën rreth rendit të ditës?

Nedžmidin Sejdilar: Kjo është seanca e dytë që ju nuk na dërgoni materialin dhe ne kemi marrë vendim që ju të na dërgoni materialin në formë fizike. Ose une thjesht nuk e mora materialin. Pse nuk e bëni këtë. Mendoni se mund t'i përfundojmë shpejt këto 3 pikë? Qytetarët presin shumë përgjigje për pyetje të rëndësishme. Seancën e keni planifikuar së bashku me kryesuesen e kuvendit, e keni ditur paraprakisht datën e seancës, pse e keni caktuar mbledhjen, përveç nëse po ikni nga përgjegjësia.

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush tjetër me e marrë fjalën? Nëse jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro këtij rendi të ditës? A ka kundër? A ka abstenim? Me 24 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, miratohet rendi i ditës. Fillojmë me pikën e parë: Miratimi i Raportit të Shpenzimeve për periudhën Janar-Shtator 2024. A do dikush me e marrë fjalën?

Driton Ademi: Përshëndetje për të gjithë! Atëherë unë kam disa pika të shkurta të Raporti i Shpenzimeve. Besoj që drejtori është këtu. Te faqja numër 7, drejtor, te shpenzimet për shërbime komunale – nëse nuk jam gabim unë – te shpenzimet për mbeturina, me sa kam njohuri, shpenzimet për mbeturina janë nga 39 mijë në 2023-tën, në 60 mijë. E kam një informacion që shpenzimet e mbeturinave kanë hy këtu te pjesa shpenzimet e varrimit. Po kur e kqyrish te tabela numër 6, pagesat e shpenzimeve të varrimit janë 12,900. Deshta me e ditë – me sa kam dëgjue, se nuk e di

shumë sigurt – a ka najfarë kontratë mes Ekoregjionit edhe KBI-së, apo pse janë të rritura 60 mijë? Nëse është me Bashkësinë Islame, është mirë me dalë me e shpjegue. Te tabela numër 7, faqe 9, deponi e mbeturinave – 20 mijë euro. Çfarë deponie është bo te këto mbeturinat. Te pajisjet tjera – ndërtimi i dyshemesë, blerja e pajisjeve te Shkollës “28 Nëntori”. Kryetari, në takimin që e kemi pas me Kallxo.com, e ka premtue që do të bëhet brenda dy javëve kjo. Kryetar, është mirë mos me dalë me permtue, se një herë e ke hap, që u mbajt Festivali, atë sallë, po ajo ka qenë e papërfunduar. Edhe mas dy javëve pse ia ke premtue këtu Kallxo.com, nuk e ke hap atë. Pse nuk ke dalë me pranue që ajo sallë hapet me ditën e Shkollës, më 28 Nëntor. Është mirë me dalë me e thënë që ka me u bo prerja e shiritit më 28 Nëntor, për ditën e Shkollës. Te ndërtim i Parkut në Bresanë, qetu 34 mijë euro. Unë nuk e di që janë shpenzue këto paret, se shumica e punimeve kanë mbet pa përfundue. Nuk e di kur do të përfundohen këto punimet. Pagesa është bo 34,286 euro, po punimet nuk janë krye. Edhe të pagesat e vendimeve gjyqësore. Drejtor, kisha pas qef një pyetje me e ditë, se edhe muajin e kaluar te puna e pagave, është mirë me e ditë edhe na edhe qytetarët, te pagesat sipas vendimeve gjyqësore, prej cilid kod buxhetor janë marrë këto paret, që janë bo pagesa 571,820.23 euro. Faleminderit!

Shpetim Hajredini: Përshëndetje, i nderuar kryetar, të nderuar drejtorë, kolegë/e asambleistë! I nderuar përfaqesues i OSBE-së, qytetarë të nderuar të Dragashit, ju përshëndes të gjithëve! Tani po duhet ne pak me e kap me nguti dhe me e krye diskutimin, pasi që kryetarin e paskna me një takim shumë shpejt. Kryetar, ti e din mirë që para dy jave na ka ardhë materiali në formë elektronike dhe e ke dit që sot na kena takim. Ka qenë mirë që takimin tjetër mos ta aranzhoni ditën e sotme, ose ta lëni me një orar pak më vonë apo një ditë tjetër. Ne jemi këtu për të diskutuar dhe nuk e dimë sa zgjat diskutimi, deri në 1,2,3 a 4, ne duhet ta kryejmë diskutimin ashtu siç kemi planifikuar ne të diskutojmë për këtë material i cili na është dërguar. Por, ju vetëm e morët fjalën dhe kërkuat që ne ta përshpejtojmë diskutimin. Atëherë, unë nuk do të ndalem shumë, do t’a bëjë nja dy pyetje, edhe pse pyetjen e parë veç e preku kolega Driton. Shpenzimet e mbeturinave, pse janë rrit drejtor kaq shumë? Është mirë ta na japësh shpjegim që ne ta dimë pse ka ndodhë kjo. Natyrisht, e kemi pa që shpenzimet e varrimit figurojnë në tableë zero-zero, ai kod më nuk qëndron, është bartur pagesa në një kod tjetër. Kish qenë mirë që ta kem përgjigjen nga ana juaj. Diçka tjetër që më ka bërë përshtypje është tek projektet kapitale. Kam lexuar me vëmendje – natyrisht që unë për fshatrat tjerë nuk mund ta di, se çfarë emra kanë rrugët dhe si janë emërtuar projektet, ku kanë mbetur apo ku janë finalizuar ato projekte, por për fshatin Kuk unë e di mirë që

kubëzimin e Rrugës “Samidin Emini” dhe Shelqja e Drugës, te këto dy rrugë nuk është bërë asgjë. Nuk është punuar në këto dy rrugë, në rrugë tjera po. Është mirë që, kur të planifikohet buxheti për projektet, të shënohen saktë rrugët, dhe emërtimi i punimeve të bëhet në munyrë të saktë dhe të duhur, jo të shënohet diçka tjetër dhe të punohet diku tjetër. Dhe diçka tjetër, i nderuar drejtor: Të hyrat vetanake, tatami në pronë, e bëra një krahasim, e pashë, po më befasojsh, se ishit shumë optimistë, keni rreh shumë gjyks. Në 2023-tën keni 278,282.28 nga tatimi në pronë, ndërsa vitin 2024, deri në këtë moment i keni 218 mijë. Diçka ke ngec, drejtor, qetu. A qytetarët janë revoltue, a çka ka, pse s’po paguajnë? Pres përgjigje për këto pyetje të mia. Ju faleminderit!

Qamil Kolloni: Përshëndetje për të gjithë! Faleminderit për pyetjet! Janë realisht pyetje të cilat qëndrojnë. Pyetjes së Driton Ademit për mbeturinat dhe pse ekzistojnë 12 mijë euro për varrimin, ju njoftojmë se deri në vitin e kaluar edhe këtë vit, borxher të cilat kanë mbet janë paguar 12 mijë euro prej vitit të kaluar. Këtë vit kemi diskutue se nga subvencionet nuk na është lejuë dhe kemi bisedue edhe për çështje tjera, sidomos edhe për subvencionet në bujqësi, për arsye se qeveria nuk po na lejon që nëpërmjet subvencioneve t’i bëjmë këto. Atëherë kemi bërë një kontraktim, si ndërmarrje profesionale që është për mbeturinat, dhe këto pagesa i kemi bërë përmes kësaj organizate dhe vazhdojmë t’i bëjmë, për arsye se nuk kemi gjet metodë dhe model tjetër i cili do të na sanksionojë ekonomikisht. Për këtë arsye ia kemi arrit qëllimit që ta tejkalojmë edhe këtë sfidë që në gjysmë të rrugës na është ndërprerë kontraktimi përmes subvencioneve. Prandaj, qajo pjesa 12 mijë euro është krye me qato mjete të cilat kanë qenë të ndara prej subvencioneve, dhe pastaj pjesën tjetër e kemi bart dhe këto janë reflektue si shpenzime pak më të rritura. Tash, kodet e mbeturinave, e ke atje te Investimet Kapitale 20 mijë euro që kemi investue në mirëmbajtjen e mbeturinave. E ke te pasyra në fund, nëse duesh, shkojmë e kqyrim krejt çka është investue edhe aty për mbeturinat, për secilën. Sa i përket ndërtimit të parkut, parku është një send që shihet, dhe në aspektin financiar, përmes vlerës që është pague me ato mjete. Ne jemi duke bërë raporte financiare për ato, po ti që ke supozime, ato janë çështje të tjera që duhet të folësh me menaxherin e kontratës. Sa i përket asaj, ne mendojmë se në bazë të Komisionit edhe menaxherit, këto punë janë krye dhe këto pagesa janë krye. Driton, sa u përket pagesave të vendimeve gjyqësore, besoj se raportin nuk e ke përcjellë shumë mirë, se nuk kemi vetëm te Investimet Kapitale, po kësaj here na ka prek në të gjitha kategoritë. Në qoftë se më lejohet, të tregoj në detale si e kemi situatën. Falë angazhimit të kryetarit dhe të kësaj qeverie do t’ia dalim, pak me probleme, sepse kontrata kolektive, jo vetëm Komunës sonë, por të gjitha komunave u ka shkaktue probleme. Realisht, jemi

e vetmja Komunë që pak më lehtë edhe më mirë jemi duke e kalue. Disa komunave i është bllokue edhe sistemi i pagesave. Në kategorinë Paga dhe Mëditje na janë marrë 202,130 euro. Mallra dhe Shërbime na janë marrë 61,550 euro; në Shërbime Komunale na janë marrë, që janë shpenzime fikse dhe nuk bën të merren, edhe këtu në këtë kategori na kanë prek, na janë marrë 2,773 euro. Kurse te Investimet Kapitale na ka marrë 571,820 euro. Domethënë, janë shumë tepër e madhe. Totali vjetor për Komunën tonë janë 838,274 euro, deri në ditën e sotme. Por çka është e keqja, frika më e madhe është se sa do të na marrë tash në tremujorin e fundit. Sepse ne kemi të kontraktuara investime kapitale dhe presim me i krye obligimet. Kemi Mallra dhe Shërbime që preim me i krye pagesat; kemi Shpenzime Komunale të rrymës që duhet me i krye pagesat. Kemi edhe pagesat e varrimit dhe jemi në një situatë ..dhe kjo nuk është më brengë vetëm e kryetarit dhe e drejtorit të Financave, por duhet të jetë brengë edhe e të gjithë delegatëve këtu, në qoftë se e ndieni veten si përfaqësues të popullit. Sepse këtu po preken interesat e përgjithshme. Këtë kontratë, nuk kemi mundësi ligjore dhe kapacitet që ne mundemi me e ndërpre ose me e ndryshue. Këto janë vendime përfundimtare që i merr gjykata dhe duhet të ekzekutohen. Andaj, gjithmonë kur diskutojmë rreth kësaj çështjeje, është pasojë e vitit 2015 por ne duhet me e krye. Me vështirësi po, por duhet me e krye, se nuk kemi rrugëdalje tjetër. Shpetim, për këtë emërtimin e rrugëve, une e di është në Kuk diku, si emër nuk mund të të jap sqarim, të kërkoj falje! Tek të hyrat vetanake, ju e dini se me Vendim të këtij Kuvendi, kemi marrë vendime për tatimin në pronë, realisht në bazë të përqindjes kemi ulë 2%. Kemi ulë edhe bazën nominale dhe ju e shihni se nëpër fatura kemi, secili objekt në Komunën e Dragashit, secila shtëpi, secili qytetar, ka fitue ma tepër se 20% ulje në tatimin në pronë. Realisht, kjo ulje e tatimit në pronë, për secilin klient, ne kemi pagesa të individëve që janë pagesat më të mëdha, por vlera nuk është rrit, për arsye se i kemi ulë çmimet. Ulja e këtij çmimi ka reflektue në rënie të inkasimit të tatimit në pronë. Nëse e bëjmë krahasimin me vitin 2022 dhe vitin 2023, ne kemi mbledhë edhe një sasi të borxheve të mbetura. Këto kanë reflektue si rritje buxhetore, faktikisht. Dhe këtë vit, meqenëse kemi pas 3150 tatimpagues të rregullt, tash kemi mbi 6000. Mirëpo vlera nuk është rrit, për arsye se është ulë çmimi. Me rëndësi është për ne shumë, se qytetarët janë vetëdijesuar dhe kanë filluar me të madhe me bo pagesa. Ne bashkërisht kemi marrë vendim për uljen, për me e mbrojt qytetarin mos me u rrit këto. Është një çështje tjetër që dua ta njoftoj këtë Kuvend: vitin tjetër kemi tatimin progresiv në pronë, Qeveria ka marrë vendim. Nuk e dimë çka do të reflektojë vitin tjetër dhe sa do të rriten shumtat. Gjithashtu, e kemi edhe një problem tjetër. Vitin tjetër do të ketë rritje në tatimin në pronë diku 300% për

pronat e bizneseve. Dhe kjo i atakon bizneset, a Qeveria Lokale nuk ka mekanizëm me e ndërpre këtë. Këto janë ato politikat shqetësuese, që nuk kur të flasim si delegatë dhe si përfaqësues të popullit, këtu duhet ta kemi shqetësimin, ku preket ekonomia lokale. Prandaj, derisa i kemi hylë vetë të hyrat, me Vendim të Kuvendit, reflektojnë si më të ulëta.

Bexhet Xheladini: Të nderuar, ju përshëndes të gjithëve dhe këtij Kuvendi i dëshiroj punë të mbarë! Mua m'u bënë nja dy pyetje të vogla. Dola t'i jap sqarim Dritonit. U tha se unë e kam bo përrurimin e sallës. Nuk është e vërtetë që ajo sallë është përruruar. Atë ditë kur është mbajt Ekspozita e Qenit ilir të Sharrit, plani ka qenë që kjo ekspozitë të mbahet jashtë, por atë ditë ishte jashtëzakonisht shi i madh – sigurisht ke qenë aty prezent – dhe ne blemë disa najllona, i shtruam dhe u detyruam atë Ekspozitën ta mbajmë brenda. Ne planifikojmë për nder të 28 Nëntorit ta hapim atë, edhe pse shumica dërmuese e punimeve – mbi 99 % - janë krye. Planifikojmë që ta hapim për 28 Nëntor, është një datë shumë e rëndësishme për ne. Është edhe Dita e Shkollës. Kështu që, ndoshta edhe ju nuk keni diçka kundër nëse hapet atë ditë. Për Parkun, 99% të punimeve të Parkut është krye, edhe është bo pagesa për punimet që janë krye. Për disa punime të vogla që kanë mbet pa krye, nuk është bo pagesa, ato punime të vogla na i kemi paraprë që ta bëjmë pagesën vitin e ardhshëm, edhe punimet kanë me u bo vitin e ardhshëm. Janë do punë jashtëzakonisht të vogla, kështu disa punë dekorative. Faleminderit!

Driton Ademi: Kryetar, një replikë shumë të shkurtë po due me ta bo, pasi u ndërlidhe te qajo pjesa. Ti ia ke dhënë premtimin te Jeta Xharra, që pas dy javëve do ta hapim. Për sallën ke thënë. Po ne jse. Dy çështje që i ka ajo sall: A e ke pa telin, tensioni i rrymës ku është i qitur nëpër mur? Edhe me Samidin e kemi diskutue bile, që diçka mund me ndodhë, se aty ka edhe stiropor. Edhe pjesa e dytë, që të kam kërkue për ndalesat e borës, jau ka vu veç nga një rend, nuk i ka vu sa kemi kërkue edhe sa kemi diskutue. Edhe aty nuk vjen ndalesa e borës gradualisht, po apert munden me shkaktue dëme te fëmijët që qarkullojnë aty në shkollë. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do edhe dikush me e marrë fjalën? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro miratimit të Raportit të Shpenzimeve për periudhën Janar-Shtator 2024? A ka kundër? A ka abstenim? Me 13 vota pro, zero kundër dhe 3 abstenime, e miratojmë këtë pikë të rendit të ditës. Vazhdojme me pikën e dytë: Miratimi i Planit të Veprimit për Personat me Aftësi të Kufizuara 2024-2028.

Agon Baxhaku: I nderuar kryetar, z.Bexhet Xheladini , e nderuar kryesye znj.Arjeta Qafleshi Skeraj, të nderuar anëtarë të Asamblesë Komunale, të nderuar nenkryetar, të nderuar drejtorë dhe të tjerë të pranishëm. Sot kemi para nesh një dokument të një rëndësie të veçantë, Planin Komunal të Veprimit për Persona me Aftësi të Kufizuara (PAK). Ky plan është rezultat i një angazhimi të përbashkët dhe të vazhdueshëm për të krijuar një mjedis më gjithëpërfshirës dhe të drejtë për të gjithë qytetarët e Komunës sonë. Personat me aftësi të kufizuara përbëjnë një pjesë të konsiderueshme të popullsisë së Komunës së Dragashit. Si shoqëri dhe si qeverisje lokale, kemi detyrimin moral dhe ligjor që të sigurojmë mbështetjen dhe mundësitë e nevojshme për këtë kategori qytetarësh, në përputhje me konventat dhe standardet ndërkombëtare, si dhe legjislacionin në fuqi të Republikës së Kosovës. Në hartimin e këtij plani ka qenë i përfshirë një Grup Punues, i cili ka zhvilluar tre takime fizike dhe takime online për të diskutuar dhe përpunuar detajet e këtij plani. Këto takime kanë qenë thelbësore për të siguruar që plani të jetë gjithëpërfshirës dhe të reflektojë nevojat reale dhe specifike të personave me aftësi të kufizuara në Komunën tonë. Hartimi i Planit është financuar nga UNICEF-i dhe është implementuar nga organizata Doën Syndrome Kosova, duke siguruar kështu ekspertizën dhe mbështetjen e nevojshme për realizimin e tij

Objektivat e planit janë:

- 1. Përmirësimi i Shërbimeve Shëndetësore dhe Sociale:** Plani përmban masa konkrete për të përmirësuar shërbimet shëndetësore dhe sociale për PAK, përfshirë krijimin e një regjistri të veçantë dhe evidentimin e nevojave specifike të tyre.
- 2. Përmirësimi i Qasjes Fizike në Objekte Publike:** Një nga aspektet më thelbësore të këtij plani është përmirësimi i qasjes fizike në objekte publike. Ne synojmë të bëjmë të gjitha ndërtesat publike, përfshirë shkollat, spitalet dhe qendrat administrative, të aksesueshme për personat me aftësi të kufizuara. Kjo do të përfshijë instalimin e rampave, ashensorëve dhe përshtatjen e tualeteve dhe infrastrukturës tjetër.
- 3. Edukimi dhe Përfshirja:** Një tjetër aspekt i rëndësishëm është përmirësimi i kushteve në institucionet edukativo-arsimore për përfshirjen e fëmijëve me aftësi të kufizuara. Kjo përfshin ndërtimin e kapaciteteve dhe krijimin e kushteve të barabarta për të gjithë.

- 4. Punësimi dhe Trajnimi Profesional:** Përfshirja e personave me aftësi të kufizuara në tregun e punës është një synim thelbësor i këtij plani. Ne do të punojmë për krijimin e mekanizmave financiarë dhe programeve të posaçme për aftësim dhe riaftësim profesional.

Parimet Bazë të Planit

Plani Komunal i Veprimit për Aftësinë e Kufizuar është ndërtuar mbi disa parime kryesore:

- **Vetëvendosja:** Inkurajimi i jetesës së pavarur dhe menaxhimi i jetës personale nga vetë personat me aftësi të kufizuara.
- **Përfshirja dhe Mundësitë e Barabarta:** Personat me aftësi të kufizuara duhet të kenë mundësi të barabarta për pjesëmarrje në të gjitha aspektet e jetës shoqërore dhe ekonomike.
- **Jetesa pa Barriera:** Ndërtesat, transporti dhe shërbimet duhet të jenë të aksesueshme për të gjithë, pa pengesa fizike apo komunikative.

Për zbatimin e këtij plani është parashikuar një buxhet prej 288,950.00 € për një periudhë pesëvjeçare, duke përfshirë fonde për secilin vit nga 2024 deri në 2028. Ne do të kërkojmë gjithashtu mbështetje nga organizatat e shoqërisë civile, donatorët dhe sektori i biznesit për të siguruar burime të shtesë dhe për të lehtësuar kostot e zbatimit. Ky plan përfaqëson një hap të madh përpara drejt një komuniteti më gjithëpërfshirës dhe më të drejtë. Andaj ju ftoj të gjithë të votoni në favor të këtij plani dhe të kontribuoni në ndërtimin e një të ardhme më të mirë për qytetarët me aftësi të kufizuara në komunën tonë. Faleminderit!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! A do dikush me e marrë fjalën rreth kësaj pike? Në qoftë se jo, atëherë e hedhim në votim. Kush është pro këtij Plani? A ka kundër? A ka abstenim? Me 24 vota pro, zero kundër dhe zero abstenim, e miratojmë këtë Plan. Atëherë vazhdojmë me pikën e tretë, pikën eventuale.

Nexhat Selaj: I nderuar kryetar, të nderuar asambleistë, të nderuar qytetarë! E nderuar kryesuese! Fjalimin tim do ta hapi me fjalën: Larg politika nga shkollat! Do ta citoj edhe një herë: Larg politikat e këqija nga shkollat! Kur përmendi fjalën politikë në shkolla, bazohem në shumë fakte. Ato fakte janë të nxjerra dhe janë të përpiluara në mënyrën më të mirë të mundshme, duke servuar këtu para juve të gjitha ato dokumentat zyrtare dhe ato shkeljet të cilat janë bërë nga kjo qeverisje,

pikërisht nga drejtori i Drejtorisë së Arsimit. Fillojmë nga Shkolla Fillore “Fetah Sylejmani”. z.Drejtori, ju nuk patët as njohuri profesionale që në fillim të shtatorit, në seancën kur ishte paraparë vetëm një pikë e rendit të ditës. Ta propozova që të kesh fillimin e vitit shkollor, dhe falë kolegëve asambleistë, njëzëri pranuan që të gjithë. Në atë kohë parashtrova pyetjen se si e kemi gjendjen në shkolla për fillimin e Vitit Shkollor kalendarik 2024/2025. Përgjigjja juaj ishte shumë e thjeshtë: u drejtova dhe u zotova para këtij Kuvendi se na ato vizitat që ju keni bërë nëpër shkolla, gjithçka është në rregull. Qoftë në aspektin profesional të mësimit, po qoftë edhe në aftësitë fizike të shkollave dhe pajisjet e tyre, gjithçka është në rregull. Do filloj nga Shkolla “Fetah Sylejmani”. Çfarë po ndodh, z.drejtor? Të thashë i paditur për këtë fushë, u rrënoqete, tash do të emëroj superdrejtor. Superdrejtor, tri vendime të rregullta lëshohen brenda një periudhe njëmuajore, për një vend të punës. Bëhet fjalë për mësuesin për të cilin nga privatësia nuk kam qef të përmendi emër – i cili udhëheq klasën e tretë, ku një vit para se të fillojë Viti Shkollor, të ka bërë kërkesën për bartjen nga fshati Rrenc në Dragash. Mora drejtimin dhe mora zotimin nga kryetari, në mbledhjet e mëparshme, më thajë kryetar, se je i vonuar nga vendimet, vendimi i ri është lëshuar, e kemi rregulluar. Në çfarë baze ligjore, o drejtor, ndajsh një klasë në dy klasë. Një klasë të tretë me dymbëdhjetë nxënës, e ndajsh në dy klasë që të mbarojsh dëshirat e dy mësuesve. Njëri të cilin e pate 17 vjet punëtor shembullor, dhe e pate ushtar të UÇK-së dhe e qite në rrugë. E këtë tjetrin e more për teket tua, për ato premtimet politike, e solle dhe e vendose në shkollë. Ne jemi këtu gjithë për pranimin e punëtorëve, por jo në mënyrë të tillë që të krijosh huti dhe të krijosh armiqësi në mes të dy kolegëve të cilët sot po të vrapojnë, cili me ardhë më herët në orën 7:00, ta kape ditarin. Nëse nuk është ashtu, ballafaqohemi me të drejtat reale në shkollë. A nuk është ky turp, që po e shkelish, po e kthejsh arsimin të cilin e kemi shembullor, jo te vitet e 2000-ta, por para viteve 2000-ta. E ke prur arsimin në nivel sikur kur kemi qenë jashtë objekteve shkollore me dhunë nga represioni serb. Vazhdojmë, akoma më prekës: A ke njohuri, drejtor, se në shkollën fillore “Fetah Sylejmani” ke kërkues të vazhdueshme nga komuniteti për sjelljen e mësuesit në gjuhën shqipe? Që ne duhet të jemi krenarë që nga komuniteti kemi kërkesa të vazhdueshme. Çfarë po ndodh me ju, pse nuk sillni mësues? Ata me plot dëshirë dëshirojnë ta mësojnë gjuhën e kombit të vet – gjuhën shqipe. Çfarë do të japësh ti para popullatës? Çfarë superdrejtori je? Vazhdojmë me tjetrën, po me të njëjtën shkollë. A nuk është turp që fëmijët që dy muaj e gjysmë t’i lësh pa çerdhe. A ke guxim të dalësh këtu të flasësh? Eja këtu ballafaqohu me të vërtetat, sill dokumentacionin e vërtetë, e unë i kam para teje të gjitha këto, të shkruara dhe të nxjerrura një nga një, nga secila shkollë.

Vazhdojmë në shkollën e Bresanës. Një çerdhe e diturisë, një çerdhe ku nga aty na vijnë shumë mjekë, shumë inxhinierë, shumë profesorë, të të gjitha fushave. A bën të di, superdrejtor, kënd e keni emëruar supermësues me 40 ora mësim. Këtu kam edhe kolegë mësues, profesorë. Detyrimisht do t'i drejtohem Sefës. Koleg Sefidin, jemi mësues të dytë. A mundet një mësues, gjatë një orari mësimor, t'i mbajë 40 orë, sikur qysh e kemi në një supermësues të emëruar nga ky drejtor. Bëhet fjalë për mësuesin e historisë, që 20 orë të rregullta i mban në Bresanë, e 20 orë të rregullta po të njëjtën ditë, me të njëjtin orar mësimor, paradite, i mban në Bellobrad. Unë nuk kam parë këso raste, as nuk kam has, do t'u drejtohem edhe dy ekonomistave që i kemi, në aspektin matematikor, a është e mundur, z.Qamili, z.Shpetimi – se për një ditë ne kemi 6 orë maksimumi. 5 ditë bëjnë 30 orë. Në aspektin matematikor, a mund të më gjeni arsyeshmëri, si mund të mbahen 40 orë? Ekziston një formulë e pashkruar, që shpeshherë e përmend drejtori, dy në një apo tre në një. Është një lloj i kafesë, tre në një, këtu dy në një. Po t'i merre dy ditara, me një orë mësimore. Por rruga? Po të është me një shkollë, do të thoshte kështu, po rruga? Për këto çështjet e arsimit, unë bëj lutje, jo nga asambleistët e opozitës, por edhe ju nga pozita, se të gjithë ne i kemi aty motrat, i kemi vëllezërit, i kemi fëmijët. Nga ky keqmenaxhim, ta gjujkojmë të gjithë, pa bazë partiake. Ta gjujkojmë të gjithë, mos t'i japim mbështetje partiake. Të jeni të sigurt se këto do t'i vuajnë fëmijët tanë, që kemi dhënë mund e kanë dhënë mund ata të cilët kanë ndërrue jetë, ata të cilët janë në pension dhe të gjithë ne të cilët angazhohemi që të kemi një arsim cilësor. I nderuar drejtor, superdrejtor, ke njohuri se në Shkollën Filllore në Blaç e ke me 20 orë të pranuar me kontratë të rregullt punëtorin e fizikës. Sa orë t'i mban atje? Nga kontakti të cilin kam zhvilluar, në Blaç mban vetëm 12 orë. 12 orë i keni ndarë në Bresanë. A nuk është turp i shekullit ky, që ato 12 orë t'i mban mësuesi i Matematikës – kolegë të nderuar! Mësuesi i Matematikës mban Fizikë. A i caktuar është mësuesi i Fizikës me 20 orë të plota. Nëse nuk është ashtu, ne e kemi dokumentacionin, me faqe, me nen, me ligje e me të gjitha. A nuk është turp, që është folur me muaj të tërë – jo në aspektin e mësueses, po në aspektin e nënës – të mos sigurohen orët e mjaftueshme për kolegen e cila bredhet për dy orë në atë shkollë, e herë në atë shkollë. Nuk due të përmendi edhe emra. Duke vazhduar më pas – kur i del krejt tymi kësaj çfarë ju bëni – unë me vëmendje e dëgjova në pikën dy, zyrtarin komunal i cili tha se edhe me konventa ndërkombëtare mbrohen personat me aftësi të kufizuara. Do t'ju parashtroj pyetje juve, i nderuar, që preket drejtpërdrejt drejtori. A keni njohuri ju se ne kemi pesë nxënës me nevoja të veçanta që udhëtojnë jashtë Komunës? Katër nga ta i kemi në Prizren, e një edhe jashtë Regjionit. Çfarë përgjigje do të

jepni ju, kur prindi i cili ka udhëtuar deri më tani në Pejë, për shkaqe financiare është detyruar ta largoj fëmijën nga shkolla. Çfarë përgjigje jepni ju këtu? A nuk është marrëzi e këtij superdrejtori, që vjen këtu edhe nuk ka aftësi menaxheriale që ta udhëheq këtë dikaster. Nëse ka diçka që kundërshtohet me fakte, urdhëroni, unë jam këtu. Të gjitha të protokolluara, me ligje e me nene. Shumë mirë thatë se ne kemi ndarë me qindra e mijëra euro – mos gabofsha, Qamil do të më përmirësosh – për transportin e nxënësve. Po më duket ishte 118 mijë, nuk jam i sigurt. A nuk mundi ky superdrejtori t’i ndajë edhe nja 5 mijë euro, të cilat deri vjet janë paguar. Por, politika e këtij në kokë, që të sulmojë mësuesit, pikërisht ata të cilët nuk janë në pozitë të tij, në partinë e tij, ndodhin këto të cilat po i vuajnë fëmijët. Është turp shekullor që një nënë, një babë, sot ta ketë të mbyllur një fëmijë të verbër. Unë jam shumë i sigurt këtu që nga morali ka njerëz të cilët i ofrojnë ndihmë. Por, ku mbeten institucionet? Keni premtuar se tenderët e druve nëpër shkolla do të sillen në kohën e duhur. Ne jemi në një lartësi të lartë kontinentale, mbi 1 mijë metra. Ku e dimë se çfarë moti na pret? Akoma asnjë metër/kub dru nuk është sjellë nëpër shkolla. Ju jeni zotuar se ato do të kryhen, tenderi do të dalë në shkurt apo në mars, dhe do të përfundojë në kohën e verës. Çfarë po ndodh tash? Do të citoj prapë fjalën: Larg politika nga shkolla! Do e vuajmë – kolegë asambleistë – qoftë të pozitës, qoftë të opozitës. Le të dëgjojë edhe qytetari, po le të dëgjojë edhe diaspora, që kanë dhënë mundin për këtë ndryshim. Edhe po besoj se ia ka arrit qëllimin. Është bërë ndryshim. Nuk jam ekspert i fushave të ndryshme që të flas për ndryshimet të cilat janë bërë, se nuk jam ekonomist, por të gjitha ato marrëzitë të cilat janë krijuar në aspektin e arsimit, unë do t’i cek këtu. E le të gjykojë Asambleja e këta kolegë, por do t’ju drejtohem edhe kolegëve nga pozita, edhe mbi 500 mësuesve të cilët në këtë moment po na përcjellin, të gjithë atyre prindërve të cilët sot kanë bërë peticione, me qindra informacione te kryetari, për këtë marrëzi të dekadës do ta quaja: Shkarkimin e drejtorit të ShML “Ruzhdi Berisha”. Nuk due të përmendi emrin e shkollës, por kjo do të jetë e para edhe e fundit se nuk do ta përmendi më. Me plot krenari e mban emrin e tillë, të një heroi, të një kombëtar, e nga ky superdrejtor të na etiketohet puna e atyre profesorëve të ndjerë, puna e atyre profesorëve të pensionuar dhe puna e këtyre vullnetarëve, e këtyre profesorëve të cilët nga kjo foltore dëshiroj t’i përsëndes të gjithë, të na njolloso edhe emrin e shkollës, por edhe kolektivin. Pse e them këtë? Në njoftimin për shkarkimin e drejtorit, unë nuk do të qasem tek aspekti politik, ka të drejtë apo jo është gjykata, ka të drejtë apo jo është prokuroria. Pavarësisht se unë due të ndërlihem edhe këtu. Në mes të të gjeturave për të cilat ka dhënë urdhër për shkarkim apo ndërrim të vendit të punës, ky superdrejtor thotë se në atë shkollë nuk ka

disiplinë. A s'është turp, more profesor, të thuash fjalë të tilla. Duhet të të vjen marre që të vijsh të ulësh këtu edhe të dëgjojsh këto fjalë. Sa para Komuna edhe ti ndajsh për sigurinë e atyre nxënësve, kur nuk ka disiplinë. Ne të gjithë kemi dalë nga ajo shkollë. Ja ku i kam edhe nxënësit këtu. Sa para keni ndarë për sigurinë në shkolla? Ajo shkollë që e mban atë emrin e atij dëshmori, me ata mësues, profesorë luftarakë që japin mund edhe djersë, e ruajnë xhepin e nxënësit, e ruajnë xhepin e prindit, për 5 euro të mos japin sigurim. Nuk ka shkollë të nivelit të vendit në Kosovë që nuk ka sigurim. Dhe atë sigurim e paguajnë nxënësit. Kolegë të nderuar, ndoshta nuk e keni ditë, unë si mësimdhënës po ju them. Ato paguhet nga xhepi i nxënësit. Nëse Komuna ka arritur të ndajë 118 mijë euro për bartjen e nxënësve, ai kolektiv që ky superdrejtor na njollos me fjalën 'disiplinë s'ka, ka anarki, nuk ka rregull, nuk ka mësim'. Ne vetëorganizohemi dhe vetë mbajmë disiplinën, veç fjala sigurim të kuptojmë çka do të thotë. Nga 5 euro – ju ekonomista mund të llogaritni – kemi 500 nxënës, bëjnë 2500 euro në muaj, 10 muaj bëjnë 25,000 euro. E 25 mijë euro, ne jemi ajo garda, bashkë me ata prind që i kemi shembullorë e bashkë me ata nxënësit të cilët i kemi të shkëlqyeshëm për nga sjellja dhe disciplina. E ju na akuzoni se në atë shkollë nuk ka disiplinë, nuk ka rregull. Sa herë, i nderuar superdrejtor, keni qenë – që dy vite je në atë pozicion – ta vizitosh atë shkollë? Mos të betohem këtu, dy herë. Dy herë, kur të kemi bërë kërkesë ne me shkrim, që të vijsh për ditën e shkollës, dhe ne të kemi dhënë lëvdatë. Të kemi urren për pjesëmarrje dhe për punë të nderhme. Por, njëkohësisht edhe ju keni lavdëruar atë shkollë, superdrejtor. Ju keni thënë se nga kjo shkollë është çerdhja e dijes, çerdhja e intelektualëve. Ku u bë që për katër muaj – në prill ne e mbajtëm takimin, e patëm ditën e shkollës – ku u bë bre për katër muaj të mos ketë disiplinë, të mos ketë rregull?

Arijeta Skeraj: Profesor, e keni kaluar minutazhin. Kanë edhe shumë diskutues tjerë me folë. I kemi kaluar mbi dhjetë minuta.

Nexhat Selaj: Nuk kam shumë, jam para përfundimit. E nderuar kryesi, e nderuar Asamble, e nderuar udhëheqëse, këtë kauzë na shkakton vetë ky superdrejtor. Ka fakte të bazuara. Pse? Më 23 maj të vitit 2024 është bërë kërkesë për sjelljen e punëtorëve të ri në punë. Shtrohet pyetja, kënd? Mjekun, infermierin, biologun. Kolegë asambleistë – qoftë të pozitës, qoftë të opozitës – prindër që po na dëgjonin këtu, një rekord është thyer me sjelljen e biologut i cili është prurë që dy javë. Një muaj e gjysmë, ajo shkollë e mesme, ajo shkollë e diturisë, që ky superdrejtor e njollos atë shkollë, nuk ka sjellë mësues, profesor, edhe pse kërkesa e protokolluar është bërë më datën 23.05.2024.

Nuk ka pasur kohë për pesë muaj të sjellë një profesor të lëndës së biologjisë. Çka krejt më e keqja, dy figurat më të larta të Komunës, kryetarin që me profesion e kemi mjek specialist, dhe duhet të jemi shumë krenar që e kemi, dhe kryesuesen e Asamblesë që e kemi infermiere, me një punë mbi 20-vjeçare, që jemi krenarë që e kemi – kërkesa është bo më 23 maj, ne nuk kemi mjek, nuk kemi infermier. Kush është këtu fajtor, kolegë të nderuar, që ai drejtor sot gjykohet, penalizohet, për shkelje të ligjit, për shkelje se ka pru pesë nxënës në shkollë. Ne 100 e fju mijë euro kemi dhënë për sjelljen e nxënësve, tash pa para po i largojmë ata. Të njoftohet edhe opinioni i gjerë, me fakte reale, se në mesin e atyre pesë nxënësve – mu më vjen keq që ta qes në një pozitë të tillë kryetarin – një prej atyre i cili është pru jashtë konkursit, është person që është pru në emër të kryetarit. Një person është pru nga vetë ai drejtor atje. Unë jam shumë besimtar, unë jam i lidhur edhe me emrin e madhë të Allahut. Le të kanë guximin këta, le të dalin këtu të betohen në emër të Zotit, se nuk kanë nga një person. Nuk është e gabuar edhe nëse është, pasi që ne nuk kemi sjellë nxënës të dobët, por kemi sjellë nxënës të regjionit tonë, nxënës tonit këtu. Po të kishim sjellë të tjerë do të thonim diçka. Çfarë të drejte mund të kemi ne mos të pranojmë nxënës të shkëlqyeshë, ata pesë nxënës, e neve nga transferet, nga Prizreni sivjet na kanë ardhë pesë nxënës të cilët nuk kanë mund të regjistrohen për shkaqe të konkursit, janë regjistruar në Prizren me nota 2-sha dhe 3-sha, më vjen keq po ashtu ka qenë, dhe transferet barten në mënyrë të rregullt. A nuk është meritot një nxënës i yni që ka një 4-sh, të pranohet, ose të largohet, e të pranohet një nxënës me nota 2-sha? Për të gjitha këto... po nuk ju konvenon aty ku duhet me folë e drejta dhe e vërteta të dalë në shesh, nuk ju konvenon. Me fjalën “Larg politika nga shkollat” do të mbaroj edhe këtë fjalim. E nderuara kryesuese, nëse më kërkohet nevoja, nuk do të ma ndërpresësh fjalimin. Faleminderit!

Driton Ademi: Prof, më vjen mirë që i thaje qeto fjalët, që i ke gjet qato të gjeturat, po të gjeturat nuk mbarojnë këtu. Para disa ditëve, kjo e gjetur dhe kjo qeverisje me këtë hajni e ka bo tenderin e kositësve të barit. Tenderin të cilin e ka qit në faqen është me benzin edhe naftë. Por këta çka kanë bo? Këta i kanë pru nëpër shkolla kositëset e parqeve me rrymë. Po ta llogariti, prej 12 kositësve, hajnia që e kanë pru me rrymë, është 175 euro. Për 12 kositëse, kjo hajni i ka kushtue 2100 euro. Domethënë, në vend se me e ble sa ka qenë kositësja 200 e diçka euro, kanë shkue e kanë ble kositësen me 59 euro. Bile me e pa në lirim, mundesh me e gjet edhe me 39 nashta. Unë kërktoj publikisht që kjo lëndë të merret të hetohet nga prokuroria, dhe të merret sikur lënda e kaluar që ka qenë me printera, po edhe kjo të merret më seriozisht. Kam dy pyetje për kryetarin,

ose drejtorin. Kryetar, në fillim të mandatit e kemi themelue KKSB-në. A bën me e ditë, çka është problemi që anëtarët e KKSB-së vetëm një pagesë e kanë marrë, që tri vjet gati e kanë mandatin. A ka mundësi me e ditë, pse nuk po iu bëhet anëtarëve pagesa? Për tri vite vetëm një pagesë u bo. Edhe pyetja e dytë, këshillat e fshatrave, kryetar, i ke formue me qaq nguti saqë nuk e di as vetë pse i ke formue. Për vërshimet nuk i pyete, pagesa, asnjë kryetari të Këshillit të fshatit nuk je duke i bo pagesa. Unë e di që për egon tënde, për me e qit një plus aty në performancë, i ke formue qeta këshillat e fshatrave. Atëherë, përderisa nuk bëjsh pagesa, nuk duhet nëpër investime të fshatrave me dalë me e thirrë atë këshillin, bashkë me kryetarin, unë s' di pse i formojsh këta. Domethënë, nuk janë bo as pagesat e anëtarëve të KKSB-së – vetëm një pagesë në fakt iu është bo – a kryetarëve të fshatrave asnjë pagesë nuk iu është bo. A ka mundësi me e ditë një sqarim për këtë? Faleminderit!

Nedžmidin Sejdilar: Më vjen keq që dëgjoj nga ju dhe pyes veten nëse ky ekzekutiv ka një fund. Më vjen keq që jam pjesë e këtij kuvendi, kur më duhet të dëgjoj që kjo qeveri të hakmaret politikisht përmes arsimit. Një pyetje për ju dhe drejtorin e kadastrës, a jeni në dijeni se në fshatin e tij personal para 10 ditësh ka pasur një incident në lidhje me pronën, ku ka ardhur një person nga një komunë tjetër, e Podujevës dhe ka kërcënuar qytetarin tonë se ai ka 17 djem dhe si nuk do të dalë dot nga shtëpia. Sepse drejtori juaj i ulur aty nuk po bën detyrën dhe nuk po zgjidh pronën. Kjo vlen edhe për ju, kryesuese. A do të dërgoni drejtorin në terren për të zgjidhur këto probleme pronësie tani? Që të mos përfundojmë në një situatë ku qytetarët nga komunat e tjera të na kërcënojnë. Urbanizmi është në kaos total. Drejtori juaj ka më shumë se 15 vjet atje, ai ka informacionin më të mirë. Njerëzit luftojnë me lopata për megje që nuk janë të përcaktuar, dhe drejtori juaj ulet atje dhe nuk bën asgjë. Një tjetër gjë: pse shefi i zyrës për komunitete nuk merr pjesë në mbledhje, pse nuk kemi njeri këtu, incidenti që ndodhi në Brod është pyetje edhe për të. Askush nuk foli. Për ta bërë më të qartë, 10 ditë më parë, një zotëri i cili ka blerë një vend dhe është duke ndërtuar një vikendice në Brod, ka shkuar në pragun e një banori të fshatit Brod dhe e ka kërcënuar se ka 17 djem për t'i hapur rrugën. Dhe probleme të tilla janë përgjegjësi e Drejtorisë së Urbanizmit. Shkaku i këtyre kërcënimeve është Bean, pasi nuk ka përcaktuar pronën. Asnjë parcelë nuk është përcaktuar. Kryetari duhet të kishit reaguar, pse nuk e bëtë. Rahte pse nuk ke reaguar as ti, je kryetar i Komisionit për Komunitete, po prisja që ta ngrije këtë çështje. Kjo nuk dërgon asnjë mesazh, kjo dërgon mesazhin se Ligji zbatohet nga forcat dhe jo nga institucionet. Ju

dhe Uzair Hamza duhet të kishit vepruar për këtë. Ju po copëtoni komunitetin që nuk po mbroni. Është dashur të reagojë e gjithë ekzekutivi. Pse nuk e latë të ishte nderi yt. Qytetarët kanë dy vite që ju lusin që të rregulloni rrëshqitjen e rrugës, si dhe asfaltin e qëruar në rrugën Globoçicë-Krushevë. Ju as nuk u përpoqët. Për lumin Radeshes më thatë se keni kundërpeticion dhe pëlqimin e fshatit. Njerëzit më kanë kërkuar që t'ju kërkoj ta sillni atë peticion në kuvend dhe t'i publikoni emrat e personave që ju kanë dhënë pëlqimin. Publikoni ato emra. Pse po i mbani sekret?

Artan Loshaj: Profi Nexhat, seriozisht po më vjen keq që t'u ndërpre fjalimi, por qysh po shihet, qaq probleme ka në arsim, sa që me orë të tëra të diskutojm këtu nuk do të mundim me bo veç pyetje, e jo me bo zgjidhje. Unë nuk jam i kësaj lëmie por jam i kësaj Komune dhe do të vazhdoj pak ta plotësoj profin Nexh, jo që s'di po nuk ia dhatë mundësinë me diskutue. Unë do të diskutoj rreth arsimit, për nxënësit dhe profesorët të cilët i përkasin lëmisë së shëndetësisë.

Arijeta Skeraj: Më fal, Artan, kujt nuk ia dhashë mundësinë?

Artan Loshaj: Mundësitë Nexhat Selajt deri në fund më i vazhdue problemet e arsimit. Për shkak të kohës, ose për shkak...

Arijeta Skeraj: Artan, nuk është e mirë kjo që po e thaje nuk ia dhashë mundësitë, kur mundësitë i pat mbi dhjetë minuta. Unë s'mundem me u bo superkryesuese, me i dhana 20 minuta. Pse po thotë para mediave që s'ta kam dhënë fjalën, kur ti fjalën e pate dhe i debatove krejta. Okej, ia japim fjalën kur t'i përmendet emri, munden me i bo. Ne u morëm vesh me z.Selaj. Por, mos më thuaj që nuk ia dhaje mundësinë. Mundësinë thuaj ia ke dhënë. Faleminderit!

Artan Loshaj: Nuk i ka mjaftue! Po mundesh me u bo superkryesuese, sikur qysh i ke superdrejtorët, s'është problem. Unë do ta vazhdoj, kryetar, me juve edhe me drejtorin e Arsimit. Në shkollën "Ruzhdi Berisha", dy profesorë, njëri i cili në muajin prill zyrtarisht DKA-së i ka bërë shkresë zyrtare që nuk do të vazhdon, prej 1 shtatorit nuk do të vazhdojë si profesor i lëndëve profesionale në Gjimnazin "Ruzhdi Berisha". Dhe i dyti, i cili 7 vite ka qenë i mirë dhe pas 7 viteve ia keni hap konkursin. Të dytë kanë punuar nga 7 vite, e dini shumë mirë, mos të shkoj me emra. Problemi është këtu shumë i madh, kryetar, për arsye se fëmijët tanë atje që janë, janë tri gjenerata edhe janë 6 klasë. I ke tri gjenerata të mjekësisë dhe tri i ke të farmacisë. Janë 6 klasë me 9 lëndë profesionale. Je kryetar, je doktor, mjek, kryesuesja është e të njëjtit profesion. Bëni me mend –

edhe Dr.Jetmirin e kemi këtu – tri gjenerata me gjashtë klasë, tetë lëndë profesionale nuk i kanë qe dy muaj. Ata fëmijë enden rrugëve. Është e pafalshm! Keni hap konkurs, hala s’i keni marrë profesorët. Më 27 dhjetor – unë sa e di – është përfundimi i gjysmëvjetorit të parë. Dy muaj kanë kaluar. E dëgjova profin Nexh, mbi 40% të mësimit në qoftë se një nxënës mungon, ai nuk do të mund të notohet. Qysh keni me mund me i notue këta fëmijët në muajin dhjetor? Tri gjenerata do ta përsëritin klasën. Është e pafalshme për nxënësit që bëjnë rrugë, është e pafalshme për familjarët, për prindërit e tyre. Domethënë, tetë ora profesionale, ata gjashtë orë i kanë, dy i mbajnë, katër shëtitin nëpër Dragash. As anën praktike nuk e bëjnë, as në shkollë, por as në QKMF nuk vijnë. Duhet këta nga Qeveria të bien një Komision në arsim, me e pa se duhet së paku drejtori i Arsimit ta japë dorëheqje. Tri gjenerata të mos notohen, tri gjenerata ta përsëritin vitin shkollor, kjo është e pafalshme. Qe edhe profin Sefë e kemi këtu, edhe Gashin. Qysh është e mundshme këta fëmijë të notohen? Është e pafalshme. E dyta: Dje në Komitet kam kërkuar nga kryetari edhe nga kryesuesja, për sot ta sjellin – nuk e di a e kanë sjellë, kërkoj nga këta që në seancën tjetër të rregullt të na bien listën përfundimtare të personave të cilët janë prek gjatë vërshimeve para katër-pesë muajve. Dje ia kam bo një pyetje kryetarit, por kryetari smartdrejtorin e qiti me m’dhënë përgjigje. Direkt kryetari i Komunës - për hir të qytetarit që kam respekt edhe për familjarët e tij, nuk dua me emër të shkoj – direkt kryetari i Komunës ka qenë i akuzuar që ka bo ndikim te Komisioni për mos me shkue në vlerësim e dëmeve të cilat janë shkaktuar në familjet e tyre. Edhe një herë, kryetar, dje të kam lyp përgjigje prej juve, ju e keni qit smartdrejtorin, unë s’mundi me e kuptue atë edhe kam dalë jashtë, se s’kam aftësi me e kuptue superdrejtorin. Kërkoj nga ju, vetëm a është e vërtetë apo jo? Në qoftë se nuk është e vërtetë, të kërkoj falje. A qytetari ka bo – ju kam kallxue dje – është shkrim zyrtar në rrjete sociale. E treta: Dje kryetar, ta kam bo një kërkesë, se unë shumë foli në Komitet edhe heshti këtu, por sot më ke detyrue. Kërkoj – si Nedžmidini – të jetë zyrtari për Kthim dhe Komunitete, si është ajo zyra atje – Uzair Hamza. Ta kam lyp një listë të tri viteve të fundit, të investimeve dhe subvencioneve në komunitet, të riatdhesuarve, kush janë ata persona, sa kanë përfitue, se është një listë që duhet të jetë zyrtare, edhe që është investue nga Komuna e Dragashit ose nga Qeveria. Sot bëj kërkesë nga ju që në seancën tjetër të na bini edhe raportin nëntëmujor të asaj Zyreje, qysh e ke pru Raportin e Ministrisë së Ekonomisë, në seancën tjetër, kryesuese, kërkoj edhe nga ju, si asambleist – të shkruhet aty – që të vjen raporti i harxhimeve nga ajo Zyrë, për seancën tjetër, se kam disa dyshimet të miat unë për keqpërdorime, edhe njerëz të cilët nuk e meritojnë të subvencionohen, por kjo Zyrë është mbi të gjitha, nuk ka

ligj edhe nuk ka Maliq për këtë Zyrë, se kryetari e ka shumë të favorizuar edhe e ka për qefi Uzair Hamzën. Edhe e fundit, znj.kryesuese edhe z.kryetar, e kemi një problem në fshatin Rrenc – ju kam potencuar edhe dje në Komitet, po sot pak më gjerë e gjatë – punimet të cilat janë duke u bërë në fshatin Rrenc, që shkon Ujësjellësi për 15 fshatra – është shumë mirë që po bëhet, keni punue mirë, keni edhe lëvdata – por gjatë punimeve, në hyrje të fshatit Rrenc rruga kryesore është e dëmtuar shumë, dhe kërkesa e qytetarëve është që ajo rrugë të riparohet. Para kamerave këtu le ta shohin qytetarët, është shumë e dëmtuar, pastaj problemi ma kryesor që është, në varrezat e fshatit Rrenc, te Rruga Kapre – Rrenc, që është bërë hapja e asaj rruge, është hapur kanali por nuk ka dajle. Ato shirat atmosferike do të dalin në rrugë dhe do të bëjnë probleme në anën e poshtme të livadheve, të arave të qytetarëve. Por krejt në fund, që kanë shqetësim qytetarët dhe me siguri vjen edhe një peticion, në qoftë se nuk ndërhyhet, është problemi që, qa shumë që e ka bo groposjen, ka shkue deri në fund të telave ku janë të rrethuara varrezat, edhe këtu ka problem edhe ka shqetësime nga qytetarët, se mundet shumë lehtë të shembet dheu dhe varrezat të dalin në rrugë, eshtrat e më të dashurve munden me dalë në rrugë. E lusim kryetarin, në emër të fshatit, pa politikë kryetar, që sa më shpejt – derisa s’jemi futur në dimër – ta bëni një sanim të asaj, ta bëni një mur mbrojtës, se me të vërtet është shumë rrezik. Këto foto kam me t’i pru edhe në zyrë, me ngjyra, këto foto do t’i postoj edhe në Facebook, por po pres mos po merrni masa, se me të vërtet është shqetësuese. Edhe krejt në fund, ndriçimi në fshatin Rrenc. E kam bo pyetjen, po në seancën e fundit kam pas do probleme familjare, nuk kam qenë prezent këtu të marr përgjigje. Tenderi ka qenë për 20 mijë euro, ju kam thënë që nuk do të bëhet, keni hapur tender dyvjeçar. A ka me fillue sivjet ndriçimi, se muaji nëntor erdh, edhe 15 mijë euro për vitin tjetër nga cilat të hyra do t’i merrni. Faleminderit!

Nexhat Selaj: Të nderuar asambleistë, jo dhjetë minuta, por 100 minuta të flasësh për arsimin në Komunën tonë janë të paktë. U shtrua pyetja nga kolega, tha për mësuesin, profesorin e mjekun, pikërisht infermierin. Kolegë asambleistë, profesorë të nderuar që na dëgjoni, arsimtarë, nxënësa e ju kolegë, për keqardhje ju them, mjeku i ka dhjetë orë në javë, infermieri i ka dhjetë orë në javë, kryesuese – se je e kësaj lëmie, e kësaj fushe – kryetar, me keqardhje po të drejtohem, dhjetë orë të mjekut në javë, dhjetë orë janë të infermierit në javë bëjnë njëzet. Lëndë profesionale. Katër javë ka muaji, bëjnë 80 orë profesionale, qe dy muaj mësimi nuk është mbajtur, kolegë. Kolege asamblesite, po ju drejtohem se deri dje ju kam pas nxënëse, edhe e dini peshën e Gjimnazit. 180

orë të shënuara në mënyrë të përpiktë i ke të humbura në Gjinnaz, në fushën e mjekësisë. Lëndë profesionale, doktor. Çfarë superprofesori do të bjer i nderuari në fjalë, supërdrejtori i DKA-së, që ta notojë nxënësin në fund të gjysmëvjetorit të vitit. Me ligj, nga Ministria e Arsimit është, që nëse një nxënës nuk përcjell 40% të orëve mësimore, ai nxënës nuk ka të drejtë notimi. Këtu jo 40%, këtu ka kaluar mbi 55% të orëve profesionale të pambajtura. Me çfarë të drejte ligjore do të notohet ky nxënës. Këto paralele që ne i kemi këtu, do të rrezikojnë së notuari, kolegë. Do të rrezikojnë së notuari, prind. Do të rrezikoheni së notuari, nxënës. Ju bëj thirrje, pa parti, larg politika nga shkolla, nga ato teket e juaja se kënd ta bini. Ktheni mjekët, ktheni infermierët, ashtu si kanë punuar, që të vazhdojnë të kryejnë këta nxënës vitin shkollor. Më se i sigurt jam, jo mujoren t'ia paguajmë nxënësve, po detyrohemi edhe nga një drekë me ua pague, nuk vijnë me këtë menaxhim të dobët. Jo nga drejtorët e nga profesorët, nga drejtori në fjalë. Duhet të jetë shumë transparent, nuk ka aftësi menaxhimi ta udhëheq këtë dikaster. Urdhëro, del e përballu para nxënësve, përballu para kolegëve, çfarë të ndodhë me 160 orë të humbura. Kush merr llogari? A duhet të shkarkohet drejtori për atë luftë që bën...ne për çdo orë kemi nga 30 nxënës, i nderuar drejtor, kolegë, nga 30 nxënës i kemi në pauzë. Ne dimë si menaxhohemi, ka arsimtar, profesor që nuk është ligjërues në atë klasë, vetëm e vetëm ta ruajë xhepin e nxënësit, mos të del në rrugë, shkon e mban orë. E kjo është nga keqmenaxhimi. I drejtorit të shkollës. Del këtu, Samidin, edhe ballafaqohu me këtë. Ku nuk të konvenon hasish në vesh të shurdhër. 160 orë të humbura, kush i ka fajet këtu? Drejtori i shkollës, ai është punëmarrës. Në maj, më 5 maj e ke dokumentin të protokolluar, që ka kërkue mjekun edhe infermierin. Fajet i ka shkolla, fajet i ka Gjinnazi, fajet i ka kolektivi për disiplinë, fajet i ka kolektivi për mospunë, fajet i ka kolektivi që nxënësit dalin në rrugë për mossjelljen e mjekut. Të lutem, ju bëj thirrje, kolegë, asambleistë, çone zërin të gjithë për fëmijët tanë, për mbesat tana, për nipat tanë, që të sjellim dituri dhe të sjellim atë që i ka hije atij Gjinnazi. Faleminderit!

Jetmir Ajdini: Përshëndetje për të gjithë! Kryetar dhe drejtor i Arsimit, në Marrëveshjen e koalicionit, para se me ardhë në pushtet – në mes të VV'së dhe LDK'së – njëra prej pikave të marrëveshjes ka qenë Drejtoria e Arsimit. Në atë Marrëveshje, DKA-ja i ka takue VV-së. Ka qenë pika kryesore e prishjes së atij koalicioni, qaj koalicion që ju ka pru juve në pushtet, që ju jeni sot kryetar dhe jeni ju sot qeverisje lokale. Po ju del të jetë drejtoria më problematike e krejt kësaj qeverisjeje. Është drejtori i dytë me radhë që e zëvendëson, njëri të ka dhënë dorëheqje për shkak

të mosdëgjueshmërisë të urdhërave të kryetarit. E, tjetri të ka ardhë drejtor që i dëgjon urdhërat e kryetarit, por aftësi për me e udhëheq këtë drejtori po shihet që nuk ka. Ke fillue me zëvendësimin e drejtorëve të shkollave fillore, i ke zëvendësue me militantë tutë partiakë. Njërit prej kolegëve tanë ia ke marrë edhe mandatin e asambleistit dhe e ke bërë drejtor shkolle. Ke fillue me të gjitha shkollat ashtu, ke vendos militantë tutë partiakë, njerëz të dëgjueshëm tutë. Tash të ka ardhë radha me e prek edhe Gjimnazin, ke vendos edhe drejtor të Gjimnazit me e vendos një militant tëndin partiak, një njeri të dëgjueshëm tëndin. Asnjë ankesë prej profesorëve për udhëheqje të shkollës nga ai drejtor. Ke provue edhe në mënyra të ndryshme me i shue zërat opozitarë, t'u e prek bashkëshorten e asambleistit tanë, Uran Halimit, me zvogëlim të numrit të orëve, orë të cilat hala nuk ia ke kompenzue. Ke thënë që ke me ia kompenzue, nuk ia ke kompenzue hala. Shkollat kanë problematika shumë më të mëdha, shkollat kanë nevojë për staf, për plotësim me staf të arsimtarëve, e jo të humbin nxënësit orë – siç i ceki profesori – me qindra orë profesionale të humbura. Ata nxënësia nesër kanë me qenë infermierë tanë, kanë me qenë doktorët tanë, edhe kanë me na dhënë shërbime neve. E ata e fillojnë vitin shkollor, domethënë është muaji tetor, fundi i tetorit, ata nuk kanë mbajtur asnjë orë profesionale, për shkak të paaftësisë suaj për me sigurue staf akademik, staf i cili i vyen shkollës edhe i jep ato orë mësimore. Drejtori i Arsimit duhet me u marrë më shumë me këto problematika, me sigurimin e stafit, me sigurimin e mjeteve të punës, me sigurimin e materialit harxhues të cilin e kërkon secila shkollë, me sigurimin e laboratorëve, e kushteve më të mira për nxënës, me sigurimin e objekteve, mirëmbajtjen e objekteve e të gjitha këto. E jo drejtori i Arsimit me u marrë me politikë, kush vjen e kush nuk vjen drejtor i shkollës. Keni shumë punë më të mëdha, keni shumë probleme më të mëdha, jo me u marrë me politikë të zëvendësimit të drejtorëve. Zëvendësimi i drejtorit bëhet kur ka shkelje ligjore. Pikë!

Samidin Xheladini: Të nderuar delegatë, të nderuar të pranishëm, ju përshëndes të gjithëve! Për fat të keq, unë një mori informata i mora këtu. Prej njerëzve të cilat janë të kyçur në politikë, po në fakt nuk po dinë me bo politikë. Po ia vënë topin në penal drejtorit. Po i kallxoni argumentet edhe vetë po e kritikoni – qato argumentët që po i lansoni po i kritikoni vetë, po jepni arsye pse qenka shkarkue. Po më vjen keq, unë sot dëgjova që drejtori qenka shkarkue. A është e vërtetë? Unë ju betohem se këtu po dëgjoj. Njëri më ka pyet në rrugë, më erdh absurd – më ka pyet me zini i Bresanës, i thashë unë s'kam haber. Pasha Zotin, pa rrena, tash e dëgjova prej profesorit. E dyta: Kur u emërua drejtori, e dini ju qysh e keni emërua. Kryetari i Komunës, bashkë me drejtorin,

kanë pas dosje, edhe na qetu në Asamble kemi pas shqetësim se kryetari po na shkon në burg, e drejtori po na shkon në burg. Edhe udhëne drejtori. U emërua në mënyrën me joligjore. Baba i kryetarit të OSBE-së ka qenë këtu, me mision, ka qenë inspektor, republikan, dhe ka ardhë Komunës sonë i ka kallxue që nuk bën ky me u zgjedhë drejtor, se është shkelje flagrante e ligjeve në fuqi. Dhe na kemi hesht. Pse? Se na krejt jem si peri për gëzofi. Krejt jemi të lidhur miqësi, jarani, muhabet, se jemi Komunë e vogël. Nuk na kanë konvenue neve veprimet e tilla, por kryetari i Komunës atëherë ka thënë unë jam kryetar, marr vendime, unë jam baba. E baba, shkojsh atje, japish llogari. Drejtori ka bo punë, na kurrë s'kemi pas vërejtje për punën e drejtorit. Nashta ka pas, po na s'kemi dhënë si opozitë kurrë vërejtje gjatë atij mandati për drejtorin e Gjinnazit. A ka pas vërejtje prej opozitës? Jo! Ka qenë i emëruar prej pozitës dhe në mënyrën më joligjore. Qysh kanë ndodhë ato, as nuk due me u marrë, se nuk është punë e jemja, është punë e qeverisë. Por, në qoftë se drejtori qenka i shkarkuar, ose po u dashka me u shkarkue – unë nuk po due me ia përmend emrin, se del e fol prapë ish asambleisti – tash doli edhe kallxoi qysh është situata në Gjinnaz, dhe na erdh mirë që informoi edhe po na vjen mirë shumë që po angazhohesh edhe kështu duhet me u angazhue. Me e kallxue realitetin, por duhet me e pa edhe me syrin kritik edhe lavdërues, të dy palët me i pas parasysh. Mua më erdhi çudi, drjetori gjatë fjalimit po e shoh që po i zgallon fytyra atje, me siguri ka shumë argumente ai, se nuk u brengos për këto fjalimet. Po m'u duk se atij ia dhaje topin në penall. Prapë tash po e shoh që ai ka me të dhënë argumente të fuqishme për këto që i ke diskutue ti. Profesor, më vjen mirë për angazhimin, por kur të delni këtu me lansue këso gjëra – se opinionin hutohet, nuk është mirë me e rre opinionin. U tha edhe prej një asambleisti tjetër. Menaxher i Gjinnazit është drejtori, në koordinim me drejtorin e Arsimit dhe Qeverinë Komunale. Në qoftë se ka qaso probleme qe disa vjet, ato nuk ka qenë dashtë me ekzistue, ka qenë dashtë me qenë të tejkalume.

Uran Halimi: Të nderuar delegatë të pranishëm, e nderuar qeverisje komunale, përfaqësues të OSBE-së, të nderuar qytetarë të Komunës sonë! Faleminderit për fjalën, edhe një herë! Sot kam qenë pak më i heshtur, po ma i dëgjueshëm edhe s'jam kesh, znj.Kryesuese. Ka mundësi edhe jam kesh, se e dish ti pse keshem unë, edhe kur po dëgjoj këtu çka po bëhet, seriozisht është për me qesh. Po ndërlidhemi te shumë çështje, është mirë që u përmenden shumë çështje këtu. Z.Selaj e shpalosi një mori keqpërdorimesh, sidomos në dikasterin e arsimit. Tash, zanafilla e këtyre çështjeve – e tha edhe Jetmiri – ku ka fillue, edhe fatmirësisht për opozitën, ku po përfundon. Tash,

kamera e Zotit e kryetarit e paska pa një tjetër mundësi për me u kyç aty. Te drjetori i shkollës së mesme, po më vjen shumë mirë që s'po lë anash me pa, ose s'po lë pa pa nepotizma, dallavera e trika, e ato të mirat ka nis edhe mos me i pa. U akuzua drejtori i Arsimit vazhdimisht, në fakt u anku një herë ku i kanë thënë je i padijshëm, keq ish ndie shumë. Mandej doli këtu u ankua, tha më keni thënë i padijshëm, po qe unë di diçka. Kur doli te Jeta në Kosovë, e zbuloi atë paditurinë, tha funksionojmë me rregulla të pashkruara. I nderum delegat, z.Selaj, këtu funksionohet me rregulla të pashkruara, a nuk e ke marrë vesh çka ndodh në arsimin tonë? Për atë unë e kam ngrit zërin edhe ju kam kallxue këtyre sa di ai drejtori që u ankue pse i kemi thënë i padijshëm. Z.Kryetar, nuk është mirë me e kap çdo pjesë edhe çdo kënd të kësaj Komune. Ka ardhë drejtori me performancë prej MASHTI-t, i nderum Samidin. Atëherë në fillim nuk e di qysh ka ardhë, e dish ti se ke qenë delegat i Kuvendit, mirëpo tash u zgjedhë me performancë nga MASHTI, për dallim prej juve që, me Komision të jashtëlujshëm keni emëruë drejtorë shkollash. E qata drejtorat e shkollave po jau ofrojnë juve mundësinë me i bo ato rregullat e pashkruara, me i zbatue këtu të dikush, e me e shpërblye dikë. Merrni zëvendësime pa konkurse, një mësues i merr dy rroga. Dhe kjo është mëse e vërtetë, z.Xheladini. Po të jap kohë për me e marrë fjalën, se ta ndërpre më pak si në gjysë. Po protestojsh edhe sado që po mundohesh me e mbrojt këtë qeverisje, veç po e qesish hala ma keq. Ti pak i sinqert je, se po kallxojsh çka po të pyesin qytetarët edhe s'po e dish, ti je ai i fundit që marrish vesh çka është duke ndodhë këtu. Të nderum delegatë, e kam informacionin që sot kryetari ka me e lëshue vendimin për shkarkimin e drejtorit të Gjinnazit. Ka mundësi që edhe nuk e lëshon – ia shtyna edhe deni ditë atij drejtorit. Po i di unë, se marrë informacion, përfaqësues i qytetarëve jam këtu, ata më kallxojnë mu. Të nderum delegatë, unë jo rastësisht dal këtu edhe flas, zakonisht i argumentoj ato, marr informacione në terren, lëvizim kapak. Po nisemi të infrastruktura, po më bjer me ec atë infrastrukturën rrugore që po e promovoni me shumë vullnet. Do gropa që janë ose kanë qenë në rrugët e Opojës, keni marrë me i sanue ato gropat, i keni shndërrue në kodra. Prej gropë, e keni bo kodër. E dini për çka është fjala, vozitni aty pari. Ma herët jam tut që po bina në gropë, qetash po tutem që po hypi në kodër. E keni te Brruti, atë pjesën e varrezave, u konë një gropë shumë e vogël që lehtë i ikshin qytetarët, tash komplet njëtrën trakë të rrugës e kanë bo kodër, asaj edhe s'un po i ikim. Te këto kodrat, kryetar, unë e vërtetova edhe e pashë pse ti kerrit të 2019-tës ia ke ndërrue amortizerat e mramë. Fordit tënd. Kodrat janë më të këqija se gropat ndonjëherë, mundish me i ndërrue edhe amortizerët tjerë. Po po, ia kanë ndërrue amortizerët veturës së 2019-tës. Asaj të zezës së kryetarit. Me letra është i

ndërruet amortizeri. Tjetra, u fol për orë mësimore, dikund mungojnë ato orë mësimore, dikujt i dyfishohen. I nderum Sele, mirë që i përmende ato. Kemi folë për dru, edhe qëlloj unë ndonjëherë edhe te drutë aty, kur vijnë kamionët me dru. Në fakt s'kanë qenë dru, ato kanë qenë aso rrëmojse të dhomve, do shkopa, i kishin djeg nxënësat prej nxehti. E qetash s'e keni marrë hala guximin, ose hala s'e keni marrë hapin për me sjellë dru për ngrohje të nxënësve. Po me vjen shumë keq që pjesën e druve kamera s'ta ka pa, z.Kryetar. Tjetër, kanë bo një reagim publik PDK-ja, që në vend të kosave me benzinë, vlera e të cilave – mos më lini me gabue – është e parapame sa, 17 euro a? 235 euro. Në vend të tyre, janë sjellë nëpër shkolla – sipas PDK-së, edhe kam pyet edhe nëpër shkolla çka u sjellë aty – në vend të kosës me lëndë djegëse, kokan sjellë do kosa me rrymë. U kujtova pse ka ndërrue kjo, ma mori mendja që s'dinë me i dhezë ato me benzinë. E kanë ma lehtë me e shti në rrymë, si atë fshisën e shpisë. Nëse kjo ka ndodhë edhe nëse reagimi është i rrejshëm, na jepni një reagim të vërtetë, na kallxonin çka është t'u ndodhë edhe pse s'kanë ardhë kosat me benzinë. Mandej, folëm për komisionet, unë thashë, janë zgjedhë drejtor të shkollave fillore me Komision të jashtëligjshëm, me afat të skaduar. Ju e dini, të nderum delegat, na e kemi pru edhe këtu atë formimin e Komisionit. Ne e kemi përcaktuar saktësisht – z.Sef, e dish që na kemi folë saktësisht për afatin e atij Komisionit. Bile ju, e mbaj në mend shumë mirë, keni dalë edhe keni kërkue afatin njëvjeçar, a është shtator-fund i gushti, apo janar-janar, janar-dhjetor. Domethënë, emërohen drejtorë prej komisioneve të jashtëligjshme, shkarkohen drejtorë duke kundërshtuar performancën e Ministrisë. Te pjesa tjetër, sot publikisht due me e falënderue ish-drejtorin e Arsimit i cili ka dhënë dorëheqje, apo u shkarkue – unë nuk e di – po drejtori i rizgjedhur i Arsimit goxha mbrapsht e ka nis. Edhe, a është patjetër me i fut duart në çdo cep të edukimit të kësaj Komune? A është patjetër gjithkund me e mbipopullue çdo institucion me aktivistë politikë të juajit. Bile-bile, edhe ata aktivistë të cilët janë shumë të dëgjueshëm, ata i keni të preferum. Po flasim për diçka shumë më serioze sesa që duket. Shumë gjeneratave mbrapa jeni duke u lënë pasojat me këto gjestë që jeni t'u i bo. Ajo që po më vjen më e keqja edhe më e ndijshmjja, është që gjithçka që jeni duke e bo, ka me ju kthye bumerang. Atë që mundohnu me ia bo dikuj, shumë shpejt Karma ka me jau kthye në lëkurën e juaj. Jau ka kthye dikur, je ankue shumë nëpër fushata – s'më kanë lënë me punue, më kanë largue prej punës – kryetar, pse po bëjsh hakmarrje? Feja, kamera e Zotit t'ta lejon hakmarrjen e këtij niveli, e këtij lloji, kryetar. Më ke ardh shumë keq ndonjëherë, në debate politike, kur e viktimizojsh veten, je konë ai qengji i butë. E sot e vesh lëkurën e ujkut, kryetar, e po mundohesh me e hongër secilin që këtu e ngre zërin në foltore. A

vërtet mendoni që keni me pas sukses, edhe duke i kërcënue njerëzit keni me i ndalë edhe keni me e përmbush atë egon e juaj personale? A është e vërtetë apo s'është e vërtetë, del këtu edhe më kallxo, i nderum delegat. Mundohu mos me më ndërhy, të lutem, se hiç s'të ndërhyta.

Arijeta Skeraj: Uran, minutazhin e ke kalue, kështu që, mundesh me e ndërpre! Faleminderit!

Uran Halimi: Unë nuk mundem me ta kthye fjalën, znj.kryesuese! Faleminderit shumë!

Samidin Xheladini: Të nderuar të pranishëm, parëz pata diçka me rëndësi, po harrova. Tash m'u dha mundësia me jua thënë. Në kohën kur ka qeveris PDK-ja, një numër i madh i profesorëve janë largue prej punës. Edhe atë, në ditët e para të qeverisjes së Salim Jonuzit dhe qeverisë së tij. Edhe ju të gjithë e dini. U largue, përveç tjerash, edhe baba i asambleistes, ish-kryetari i LDK-së, Fatmir Mehmeti, me baza politike. Edhe të gjithë që janë larguar kanë qenë ose partiakë, ose votues, ose të dëgjueshëm partiakë. Këtë e kanë bo me qëllime. Diskriminim total politik dhe partiak. Edhe drejtori i Arsimit të njëjtin fat e ka pas. Për rahmetliun, babën tënd a? Bëbën tënd ta kemi marrë dy herë në punë, s'ka dashtë me punue në kohën e LDK-së. Po më vjen keq, po të them publikisht, unë jam dëshmitar. Unë edhe ky kemi bë çmos edhe e kanë pranue në punë, nuk ka shkue pse ka qenë LDK-ja në pushtet. Po më vjen keq, qeky është realiteti edhe nuk të rrej. Nuk ka punue, e ka inskenue situatën në bashkëpunim me bashkëpartiakët, edhe ai ka ra viktimë, edhe kur e kemi pranue në punë – ka qenë Xhemal Iljazi drejtor, një herë ka qenë Ruzhdi Berisha, rahmetlia, atëherë kanë bo shantazh – para luftës – herën e dytë kanë bo mas luftës. Po më vjen keq, edhe po duhet me ta thënë publikisht. Ti ke qenë fëmijë atëherë, unë e di mirë, edhe ky, e kemi përjetue bashkë. Edhe e kemi marrë në punë, se e ka meritue, se ka qenë punëtor. LDK-ja ka qenë në pushtet para luftës krejt, 100%. Ju keni qenë atëherë pak, me gishta. E dyta, ti që thaje për koalicionin, ti e dish mirë, mos të t'dhëmb shumë, postin e ke pas, nuk e ke shfrytëzue. Koalicionin, ju ua keni mundësue njerëzve tjerë – se qeky zotnia ka qenë këmbëngulës edhe unë më këtë nuk jam pajtue, unë nuk kam pas qef me ju dhënë poste të cilat jua ka dhënë ky. Nuk më kanë ngue mu, as qeveria, as partia e as kërkush. Dhe jua kanë dhënë postet juve. Ti nuk ke ditë me e mbajt postin e kryesuesit, ty po të dhëmb. Se unë të kam thënë, mos bën gabime, ti ke bo. Ia ke bo vetit. E dyta, qeky kryetar nuk e ka prish koalicionin, të jesh i bindur. E ka prish VV-ja! Jo që s'kanë pas të LDK-së faj, por VV-ja e ka prish, nëse duesh, të kallxoj në detaje çka di unë. Edhe e fundit, ju nuk na keni pru në pushtet, pa ju kemi fitue, 550 vota kemi qenë pa ju. Me ju kemi hup për 39 vota.

Ku shkuan votat, bre Uran? Nuk po them për ju që jeni këtu prezent, por mos u mundo me VV-në, se 70-80% ia keni qit... edhe ju keni koalicion të fshehtë, se a po e sheh qysh po shkoni sa miras.

Nexhat Selaj: Nëse keni durim, për shkak të minutazhës, të kohës së shkurtë që ka edhe kryetari, do ta kem në konsideratë. M'u drejtua kolega Samidini. Samidin, nëse foli jashta arsimit, mund të bëj politikë. Të betohem në Zot, se kur është në pyetje arsimit, se jam mësues, nuk kam politikë. Nga Shkolla e Mesme "Ruzhdi Berisha", nr.251, më datën 23.05.2024, Dragash, për DKA-n në Dragash, lënda: Kërkesë për shpalljen e konkursit për plotësimin e vendeve të lira të punës për vitin shkollor 2024/2025. Kërkojmë nga DKA-ja që për vitin shkollor 2024/2025, të plotësojë këto vende të lira të punës: Mësim në Gjuhën Shqipe, një profesor të lëndës së Biologjisë me kohë të caktuar për një vit, me 15 orë në javë; II) dy mësimdhënës infermierë për praktikë profesionale, për drejtimin Shëndetësi – bashkëpunëtor profesional i infermierisë, nga 20 orë, tjetri me 10 orë mësim në javë; III) një profesor për lëndë teorike, për drejtimin Shëndetësi, bashkëpunëtor profesional, infermier, për 10 orë. Nuk di të flas pa dokument, Samidin. Nuk flas, të jesh i bindur ti. Këta kolegët e tu – se të gjithë i kam kolegë – këtu na pësojnë fëmijët tanë, këtu na pësojnë mbesat tona, këtu na pëson e gjithë kjo popullatë. Po në maj është bërë kërkesa për dërgimin e punëtorëve, në maj e ka bo, qe pesë muaj ta ka bo, se në shtator fillon viti shkollor. Nuk ka qenë e mundur, ky drejtor, për pesë muaj kohë, maj/qershor/korrik/gusht/shtator, të sjellë profesorë. E shtatori, tetori, po na fillon neve nëntori, ne nuk kemi as mjekë, nuk kemi as infermierë. Kur ne mbledhim mjekun edhe infermierin, nga 10 orë në javë, bëjnë rreth 160 orë për dy muaj, profesor e koleg. Vetë je i arsimuar. Plus orët praktike, asnjë orë praktike nuk e kanë nxënësit. Po mirë, m'u drejtove mu, po të drejtohem ty edhe po ju drejtohem kolegëve. Kjo është publike, nuk është e fshehtë, diçka çka është publike, diçka çka është në interes të fëmijës e të shkollës, nuk fshehi. Mund të bëj politikë në aspekte tjera. Betohem, zotohem për të madhin Allah, kur është në pyetje nxënësi edhe shkolla, jap maksimumin. Unë nuk dua të hyj në çëshjte tjera të atij drejtori, por po më nxitni që të flas. Pak edhe morali të jetë në pyetje, ka pas moral për këta nxënës që shumica ne këtu jemi, ndoshta edhe para luftës kemi shfrytëzue moralitetin e tij. Ndoshta edhe gjatë kohës së luftës, po ndoshta edhe tash na prek ndonjë familjar –jam shumë i sigurt – me atë moralitetin që ka tregue. Nuk hyn ajo në këtë, po duhet ta përmendi edhe fjalën "human". Faleminderit!

Uran Halimi: Faleminderit, Samidin, për kthimin në kohë edhe për këtë mundësinë që unë me ardhë këtu edhe me i qit do të vërteta në shesh. Tash, me folë Samidini për kohën e koalicionit,

kur ky nuk u konë as në zyrë të koalicioneve, nuk e di a ia vlen. Po më vjen shumë mirë që e zbulove atë fytyrën e vërtetë edhe iu thaje qytetarëve që LVV-ja neve s'na ka ndihmë edhe s'na ka pru vota. Këtë e thoni vazhdimisht, po nëpër kafe e tubime, e sot edhe publikisht tha që LVV s'na ka pru vota. Sidoqoftë, e di qytetari a ka pru vota a po s'ka pru vota. U çudita që thaje edhe para luftës LDK-ja u konë në pushtet, mirë, po m'i faktori do sende tjera, Samidin. S'e di unë atë pjesën. Epo, këto të bëmat që jau paskan bo, e paskit lyp. Mandej, po vërtetohen edhe do goxha çështje më të rëndësishme me qeverisjen e juaj të para luftës, e që goxha ju djeg ngapak. Mandej e përmendet babën e Dritonit, unë e kam pas mësues në klasë të dhjetë atë, ka qenë koha kur më së shumti matematikën ma ka dashtë. Shumë sinqerisht po të them, unë për numra nuk jam shumë i mirë edhe te raportet financiare nuk e mora fjalën, se i përkas lëmisë së mësimdhënies së Gjuhës Angleze. Mirëpo, në kohën kur ka qenë i ndjeri mësuesi im i Matematikës, unë e kam pas 5, që në Matematik veç në shkollë fillore me zor e merrsha 5. Kam qenë i dobët në Matematikë. Mirëpo, në kohën kur i ndjeri më ka dhënë Matematikë, unë kam qenë prej nxënësve më të mirë bon vaki. E di edhe kryetari, se djalin e kryearit e kam pas në klasë. Prej momentin kur a la punën, s'e di qysh e la punën edhe pse e la punën, unë kam qenë goxha i dobët në Matematikë. Shumë sinqerisht, ma kanë bo bajat edhe lëndën e Matematikës bile. E ajo koha ka qenë ju kur keni qenë në pushtet. Ju qe çka i boni arsimit, qe çka i boni një nxënësit. Prej superior, e degradoni. E keni degradue krejt arsimin, krejt Kosovën e keni degradue bile.

Driton Ademi: Samidin, nëse dësh me ngue tash të kallxoj unë, se parëz fole e tash unë të kallxoj. Po ta lidhi veç me pyetjen e parë, a e ke kositësen e barit në zyrë tënde të shkollës fillore? Ku e more? A është e shkollës fillore, a e jotja ajo? Kallxoi drejtorit të DKA-së, çka ka lyp në zyrën tënde kostitësja e barit të Shkollës Fillore “28 Nëntori”? E para, e dyta: 1 shtator të 2004-tës, prindi jem i ndjerë nuk ka fillue mësimin. Ju në 2004-tën e keni pas mo ofenzivën e fundit, që keni fitue, se prej atëherë mo kurrë nuk keni fitue. Kurrë nuk keni fitue, as si LDK, as si qendrore, as këtu. 1 shtator 2004-tën nuk ka fillue prindi jem mësimin. A e dish arsyen pse nuk e ka fillue? Kryetar ka qenë Halim Shemsidini, po shef i Ekzekutivit – se ti më thaje shumë i ri je, po në politikë nashta munda me qenë më i vjetër – shef i Ekzekutivit ka qenë vëllai yt, sot që është kryetar. Kryetari nuk e ka qit – Halim Shemsidini – po e ka qit vëllai yt. Prindin tem. Paramendo çfarë paradoks, shok të gjeneratës edhe të klasës, edhe kur ka ardhë puna, për çka e ka qit, për një lumë që ka hup sot KF “Bresana”, që nuk ia ka dhënë me e pastrue, se u duhke me u regjistruë Klubi, nuk ka pas pare,

3 mijë marka. E ky ia ka dhënë tjetërkujt, edhe nuk ia ka dhënë KF “Bresana”. Prej 2001-tës e deri sot, KF “Bresana” është i shuar. Nëse nuk e dish, unë të kallxoj. Nuk ka fillue në shtatorin e 2001-tës. Me marka jem t’u të folë. Se shumë i ri jam konë, që po të kallxoj, me marka jem t’u të thënë. Unë s’mundi me thënë rrenë, se s’e kam sot të gjallë këtu, mos hi shumë në personale, nuk është sot gjallë me dalë me të thënë këtu përpara. Sa për ju, që mendoni veç ju që keni punësue ose që s’keni pranue, shumë mirë ta tha Urani, kur ka dalë prindi jem prej punës, ju që e keni marrë mandej, më ka dhënë mu mandej, unë kam qenë në Gjinnaz, anglisht me ka dhënë profesori i Ekonomisë. Tre provime i ka për tri vjet në fakultet, më ka dhënë anglisht, profesori i Ekonomisë.

Samidin Xheladini: Sa i përket asaj, këtu është bo një komplot, me qëllime tendencioze. Ky ka qenë Kryeshef i Ekzekutivit – mu nuk më interesojnë punët e tija, se e di që i bën 100% mirë. Edhe kahmos, çdo punë që e bën ai, e bën 100% mirë. Kryetari i Komunës ka qenë Kryeshef i Ekzekutivit të atëhershëm. Më vjen keq, unë jam dëshmitar edhe vetë, KF “Bresana”, ka qenë shumë 1500 marka, një shoqatë i ka dhënë donacion me i pastrue lumenjtë. Krejt fshatrat i kanë pastrue, kur ka ardhë Bresana, e kemi pa na që me qëllim u bë shantazh edhe bojkot. Edhe na çka kemi bo? Na kanë dhënë mundësinë me ia dhënë KF “Bresana”. Tre veta kemi dalë me pastrue lumin, edhe kemi mbet na kështu. Mas asaj, kur është mbajt mbledhja, kanë qenë 500 veta në sallë, edhe qeky burrë iu ka thënë: Delni pastrone lumin, prej xhepit jau jap qato pare. Jo klubin, shoqërinë e kemi lut, të gjithë i kemi lut, nuk e kanë marrë. Unë tri herë e kam pastrue lumin, me forumin rinor. Por me bojkot. Për kosën në zyrë, unë nuk i di këto dreqnitë e juaja, këto dallaveret e juaja, mu më ka thirrë drejtori i shkollës, e kemi marrë një kosë, e ka pa oborrin e Ambulantës se na nuk kemi kosë. E kanë bënë bashkëpunim me këta apo pa këta, unë nuk di gjë, mu vetë drejtori më ka thirrë, se unë jam shef në Ambulantë, më ka thirrë me ma dhënë kosën. Kam shkue me kolegë, e kam marrë kosën, për shkak se na e kemi marrë edhe një kosë tjetër, edhe këta më kanë thënë edhe kabllën bile me ma sigurue përmes Komunës, në mënyrë që me e pastrue barin. Edhe çka ka të keqe këtu, kosa është aty, unë veç e kam marrë kosën edhe nuk jam kompetent.

Shpetim Hajredini: Natyrisht, sa i përket çështjes së arsimit, nuk mbeti gjë për të thënë, por po më vjen shumë keq që nëse qëndron edhe është realitet kjo gjendje e arsimit, atëherë mozomakeq për neve edhe për fëmijët tanë. Shpresoj që së paku nja 30% të mos jetë e vërtetë. Drejtor i Arsimit, kam pas shumë respekt për ty dhe nuk kam besue që arsimit vjen në këtë gjendje me ardhjen tënde. I nderuar kryetar, të nderuar kolegë, një projekt e kemi pas që i ka përfshirë shumë fshatra, çështjen

e asfaltimit, një prej kolegëve të mi këtu e potencoi. Në atë emërtim të projektit ka qenë edhe fshati Kuk, mirëpo në fshatin Kuk unë nuk di që është bërë diçka në lidhje me asfaltimin. Asfalti në fshatin Kuk qëndron po ai i atyre viteve kur është shtruar, nuk e di saktë në cilin vit, ju keni qenë atëherë në pozitë, dhe ato dëmtime të cilat janë shkaktuar gjatë viteve deri në këtë vit ku ne po jetojmë, qëndron ashtu. Pse, i nderuar kryetar, fshati Kuk ka qenë pjesë e këtij projekti dhe nuk është bërë asgjë në fshatin Kuk sa i përket këtij projekti, due përgjigje nga ti. Sa i përket çështjes së drejtorit, më erdhi mirë që i nderuar kolegj, Uran, ishte shumë realist dhe tregove që drejtori në përzgjedhjen e dytë është përzgjedhë nga Ministria edhe ka performancë, i plotëson kriteret, ka qenë gjithçka në rregull. Mirëpo, ajo që më bëri mu përshtypje ishte fjalimi i kolegës nga pozita, që tha është zgjedhë në formë të paligjshme në kohën e juaj. Po më vjen keq, ai ndoshta është zgjedhë atëherë në formë të paligjshme, por kanë qenë instancat ligjore me të cilat është dashtë të merren dhe mos ta lejojnë të përzgjidhet. Por këta tash po hakmerren në mënyrë të paligjshme po dojnë me e shkarkue atë. Nuk është mirë që të bëni hakmarrje politike. Në momentin që një punëtor, qoftë i arsimit, qoftë shëndetësor, pa marrë parasysh cilit profil i takon, dhe i plotëson kriteret, ai duhet ta vazhdojë punën në atë vend të punës ku është për momentin dhe nuk duhet të bëhen hakmarrje të tilla të jashtëligjshme, se pastaj unë jam i bindur, nëse është e jashtëligjshme keni me dalë ju keq dhe nuk do t'ia arrini qëllimit tuaj. Por, edhe atë penalin që e përmende, i nderuar kolegj, penallin vetë po na boni neve, e jo na juve. Çështje tjetër të cilën deshta ta ngris, të nderuar kolegj dhe ju qytetarë të nderuar të fshatit Kuk, ka të bëjë me rrugët të cilat janë dëmtuar nga vërshimet. Ju e dini që unë deri më sot nuk e kam ngrit këtë çështje. Në një nga seancat e parafundit, e kam bërë si pyetje, mu nuk më është dhënë përgjigje. Por unë nuk lejoj që emri im tash të lakohet si përgjegjës pse nuk po kryhen punimet në këto dy rrugë. Absolutisht jo! Unë ngris dhe mundohem gjithmonë ta ngris zërin për çështje të rëndësishme të fshatit. Edhe pse në shumicën e rasteve jam munduar t'i tejkaloj dhe mos t'i paraqes këtu para jush, për hir të respektit që kam ndaj dy personave të cilët janë pjesë e ekzekutivit. Mirëpo, më mjaft u bë! Tash e tutje, normal që do ta ngris çdo problematikë të fshatit do ta paraqes në Asamble, sepse duhet ta kuptojnë ata qytetarë që unë nuk jam përgjegjës për këtë çështje. Përgjegjësia është e ekzekutivit. Jepni ju llogari para qytetarëve se çka po ndodh me këtë projekt dhe ajo koha që keni shënuar ju në rrjetin social, shumë shpejt, tregoni çfarë periudhe kohore është, a është dy javë, a një javë, a një muaj, a një vjet a, që ta dinë qartë ata se ato rrugë kur kthehen në gjendje që të kalohet siç është më së miri dhe si kanë qenë më herët, para vërshimeve. Një çështje tjetër të cilën dua ta ngris, i nderuar

kryetar, edhe besoj që ju e keni të ditur, pasi që më thanë që kanë qenë – nuk e di, para dy viteve po më duket apo vitin e kaluar e kanë diskutue këtë problematikë – disa qytetarë, më shkurt ta themi fermerë, të cilat i përdorin bjeshkët e fshatrave siç janë fshati Kuk, Zaplluxhe, Kuklibeg etj., që posedojnë bimë mjekësore, kanë fruta të imëta dhe të cilat mezi priten nga qytetarët tanë, nga familje të shumta të cilat i frekuentojnë këto bjeshkë dhe pastaj, nga mbledhja e tyre sigurojnë të ardhura të shumta vjetore, ku edhe e sigurojnë edhe jetesën nga ato, po rrezikohen nga qytetarët e Shqipërisë. Çka mund të bëjmë na në këtë drejtim si Asamble, e ke mbështetjen time dhe të Grupit, si mund të marrim ndonjë vendim që së paku t’i kufizojmë. Ata më treguan edhe disa raste ku ka pas edhe rrahje ndërmjet qytetarëve tanë dhe qytetarëve të Shqipërisë. Është mirë që ne këtë problematikë ta diskutojmë këtu në Asamble dhe të marrim një vendim që të mos lejojmë që një gjë e tillë të ndodhë edhe një herë, apo mos të shkojë edhe te më e keqja, të ketë edhe viktimë. Edhe një çështje që po dua ta ngris, edhe pse e lexova në rrjetin social tani se ka dhënë një arsytim personi përgjegjës i “Avokos”. E kam pa një video e cila është postuar në Facebook, në TV “Opoja”, dhe e cila tregon se promovohet natyra e bukur e Komunës sonë, traditat tona, por ajo që më bëri përshtypje aty ishte se, në vend se të jetë produkti, jogurti, i Kosovës së paku, nuk po them që të jetë i Dragashit, i qumështoreve tona, ata marrin dhe në videon e tyre e reklamojnë MU-n. MU-ja nuk është jogurt i yni, është i fqinjve tanë, edhe ai nuk pasqyron kurrfarë tradite dhe kurrfarë kulture, kurrfarë produkti tonin. Shumë kish qenë më e arsyeshme që ajo video të fshihet dhe edhe një herë ta rregullojnë, ta incizojnë si duhet dhe ta postojnë, por jo ashtu ta qesin dhe të tregojnë se ne jemi pjesë e Komunës së Dragashit dhe këto janë të mirat e Komunës tonë. I nderuar koleg Uran, në matematikë thajë diçka s’po ta do. Herët e kam kuptue që me matematikë s’je mirë. Në momentin që ke bo koalicion me këta, e kam ditë që matematikën e kësaj të dobët shumë. Ju faleminderit!

Bexhet Xheladini: Të nderuar asambleistë, më vjen shumë mirë që u bë një debat shumë produktiv edhe demokratik. Më vjen mirë që disa asambleistë me vërejtjet e tyre, me kërkesat e tyre, ma dhanë mundësinë që unë t’ju jap sqarime juve, me të vërtetat edhe të pavërtetat. Më së shumti këtu u diskutue për çështjet e arsimit. Për disa gjëra që unë muj të jap përgjigje, do ta jap përgjigje, por për gjërat të cilat unë nuk do të jap përgjigje, do të jap drejtori i Arsimit, i cili do të dalë edhe do të japë sqarime për pyetjet që i keni bo. U tha se janë dhënë tri vendime brenda një kohe shumë të shkurtë, dhe për një vend të punës janë marrë dy mësimdhënës. Gjithashtu, u cek edhe çështja e

ndarjes së klasëve. Ne për këtë çështje kemi debatuar edhe në një seancë të kaluar dhe unë personalisht i kam dhënë disa sqarime për këtë. Për ato sqarime që i kam dhënë, nuk due t'i cek, por dua të cek se, kur është fjala për ndarjen e klasëve. Ndarja e klasëve vërtet është bo, edhe fizikisht është përgatit terreni, por edhe jemi bazuar në Rregulloren e cila e lejon ndarjen e klasëve në viset malore. Unë do ta lexoj Rregulloren e cila është ende në fuqi dhe ku ne jemi bazuar – vërtet është Udhëzimi Administrativ Nr.18/2009 i datës 28.08.2009. Unë do ta cek Nenin 7, ku thotë: Numri i nxënësve për paralele në shkollën fillore dhe të mesme – unë do t'i cek vetëm parafillorët 5 dhe 6, dhe nga 7-9. Zonat malore lejohen me pas minimum deri në 5 nxënës, me pas paralele. Kështu që, duke u bazuar në këtë Rregullore, kemi bërë ndarjen fizikëve të klasëve dhe i kemi bërë në vend të një klasës dy. U tha se ka arsimtar që ka mbi 40 orë. Nuk është e vërtetë, nëse dësh të biem edhe argument që nuk është e vërtetë. Personi, arsimtari i cili i mban orët tepër, i mban vullnetarisht, pa pagesë. Me përgjegjësi të plotë deklaroj se personi, arsimtari, profesori i cili i mban orët, i mban në mënyrë vullnetare, pa pagesë, edhe nuk ka me u pague derisa t'i mbajë. U përmend shkarkimi i drejtorit të ShM "Ruzhdi Berisha". Dua të them diçka: Shkarkimi nuk është politikë. Po të kishte qenë politik, kur e kam marrë unë mandatin e kryetarit, populli ka votue për ndryshime, unë kam mujt me e bo ndryshimin, mos me e zgjedhë atë drejtor. Nuk është vendimi politik, është vendim se ky drejtor e ka shkelë ligjin. E ka shkelë Rregulloren QRK Nr. 19/24 për Procedurat e Përzgjedhjes dhe Emërimit të Drejtorëve dhe Zëvendës drejtorëve, Mësimdhënësve, Bashkëpunëtorëve Profesionalë, Asistentëve, Instrukturëve dhe Sekretarëve të Institucioneve Publike Edukativo-Arsimore dhe Aftësuese IEAA të Arsimit Parauniversitar. Drejtori në fjalë e ka shkelë Nenin 17 të kësaj Rregulloreje, ku thuhet përfundimi i kontratës. Drejtori i DKA-së, që është punëdhënësi kryesor i drejtorit, kur e ka hetue që e ka shkelë këtë Rregullore edhe këtë Nen, drejtorin në fjalë e ka çue në Komision disiplinor. Ky drejtor, te Neni 17 e ka shkelë Pikën 1.4.2, ka marrë vendime dhe ka kryer veprimtari në institucionin shkollor në kundërshtim me aktet nënligjore dhe vendimet e nxjerra nga MASHTI për arsimin parauniversitar dhe rregulloret e Komunës. Ky ka marrë vendim që jashtëligjshëm të pranojë... ka bërë edhe shkelje tjera, ka fshehë orë, që drejtori i DKA-së ka deklarue të gjithë drejtorëve që orët që janë tepër duhet me i deklarue. Ai ka fshehë orë. Gjithashtu, te ky drejtor ka konflikt interesi, se njëkohësisht është drejtor i Gjimnazit dhe është drejtor i një shoqate transportuese, fituese e tenderit për transportimin e nxënësve të Shkollës së Mesme. Por për këto nuk akuzohet ai, akuzohet për këtë, për Nenin 17, Pikën 1.4.2. Ka edhe shkelje tjera të cilat do t'i qesim ma vonë. Ka shumë shkelje, edhe

keqpërdorime, edhe financiare etj., por momentalisht ai akuzohet për këtë çështje. Komisioni Disiplinor është duke punuar në këtë drejtim, edhe drejtori ka qenë pak më zemërgjerë, ka kërkuë që ndaj tij të merren dy masa: ulja e pozitës, ose largimi nga puna. Kështu që, Komisioni i ka dy opsione, dhe në bazë të vendimit që ta marrë Komisioni, do të procedohet dhe veprohet në këtë drejtim. U tha se unë si kryetar kam urdhëruar drejtorin me e regjistruar një nxënës timin në paralelen e mjekësisë. Kjo nuk qëndron, kjo është rrenë e kulluar, është shpifje dhe nuk është e vërtetë. Unë ma s'pari, mas një viti kam hetue që ai ka regjistruar nxënës jashtë kriterëve. Unë ish-drejtorin e kam thirrë në zyrë, i kam thënë se me konkurs janë të lejuar me u pranue 22 nxënës. I kam thënë edhe drejtor Zenisë kur ka ardhë. U kam thënë mos gaboni me shkue me intervenue, se ju shkarkoj juve, nëse ju intervenoni edhe e urdhëroni drejtorin në Gjimnaz me regjistruar nxënës jashtë kriterëve. Tash, drejtori i mëparshëm i Arsimit, unë e di që ai nuk ka shkue edhe nuk ka intervenue, edhe ka kërkuar decidivisht prej drejtorit të Gjimnazit që të mos bëjë këso lëshime. A ka bo dikush tjetër, Zenia, a s'ka bo, unë nuk e di. Unë me përgjegjësi të plotë e them që as nuk e di se kush është regjistruar. Kam marrë vesh para 3-4 muajve që është bërë një gjë e tillë, ai i ka regjistruar gjatë nxënës. Kur një kryetar nuk ka regjistruar nxënës, kush është drejtori i Gjimnazit i cili është menaxher, me regjistruar nxënës jashtë kriterëve. Kryetari i Komisionit për Vlerësim, i cili ka qenë aty, nuk ka mujt me e regjistruar mbesën e vet. Pse? Sepse nuk i ka plotësuar kushtet! Ndërsa, ai, kënd ka dashtë e ka regjistruar. Për këtë çështje, ai e ka shkelë Nenin 1.4.2, edhe për këtë është dërguar në Komision Disiplinor. Kositëset me rrymë dhe me benzinë: E kam lexue një reagim që e ka bo PDK-ja – i lus që ta lëshojnë videon - nuk e di unë pse e kanë bo këtë reagim, mirëpo e vërteta qëndron kështu: Kositëset të cilat i kemi porosit na, në bazë të kontratës, paramasës dhe parallogarisë, ato gjenden në deponë e Komunës, dhe ato, nëse nuk doni ju me shkue me i pa fizikisht që janë aty, nëse nuk doni, e kemi përgatit edhe videon që mund ta shihni. Nëse doni, mundemi – kerrat po ju presin jashtë – shkojmë edhe në depo me i pa, që janë, bile janë pak më të forta. Aty është lyp 1400, ai i ka prurë 1600, sepse 1400 nuk ka mujt me gjet. Janë me benzinë edhe janë 12 copa në depo, ka qe mbi një muaj. Kështu që, ky reagim i juaji i cili është bërë në rrjete sociale, nuk e di pse është bo edhe për çka u bo. Po vazhdoj unë me tjera gjëra, derisa të përgatitet videoja. U tha se pse nuk po bëhet pagesa e KKSB-së. Prej momentit kur është bo aplikimi i Ligjit të Pagave, unë jam kryetar i KKSB-së, edhe as unë nuk jam duke marrë pagë. Por edhe asnjë anëtar i KKSB-së nuk është duke marrë pagesë, edhe pse ne disa herë i kemi çue në Ministrinë e Financave me i bo pagesat, ajo nuk është duke e realizuar këtë pagesë. Por, më duket se kjo nuk

është duke u bërë në asnjë komunë, jo vetëm në Komunën e Dragashit. U tha se pse janë formue këshillat e fshatrave kur ato nuk pyeten, sidomos te vërshimet. Këshillat e fshatrave dhe kryetarët e fshatrave kanë pas një rol kyç në vlerësimin e dëmeve gjatë vërshimeve që janë bo. Ata bile kanë qenë udhëheqësit kryesorë që e kanë çue Komisionin Komunal nëpër shtëpi, për dëmet që janë bo nëpër fshatra, sidomos në ekonomi familjare edhe në bujqësi. Pagesën nuk e kemi procedue, nuk mund të them se e kemi çue me e bo pagesën edhe s'e kanë bo. Ne nuk e kemi bo, është lëshim i yni, nuk e di a mujm me e bo këtë pagesë a jo, por ne nuk e kemi bo, vetë. Jo pse s'kemi dashtë, po ja që ky është një lëshim, që mu edhe nuk më ka shkue mendja që duhet ta bëjmë një gjë të tillë. Lëshoja zërin videos. Ky është zyrtari i cili është caktuar edhe depoist, shkon në deponë e cila gjendet te Shajnja, në shkollën profesionale, edhe është duke i hap paketat e këtyre kositëseve të cilat janë me lënëdhë djegëse. Sa i përket incidentit në Brod, unë për këtë kam dëgjue nga drejtori i Urbanizmit. Ka qenë në zyrë, më ka informue, dhe menjëherë ne kemi marra masa që ky problem të zgjidhet, sepse ishte çështja e një zënke pronësore. Mirëpo, ju e dini që pronat edhe kadastru, edhe kufijtë nuk i bën Komuna, është kompetencë e Agjencionit të Gjeodezisë. Ndoshta ka edhe gabime, por këto janë bërë në kohën kur është bë aeroincizimi dhe si të tilla janë të evidentuara edhe në kadastrë. Unë kam dëgjue, më ka ardhë shumë keq që ka ardhë deri te ky incident – nuk e di a ka qenë incident apo kërcënim – por për këtë çështje sigurisht që është njoftue edhe policia, por unë kam kërkue nga drejtori që të merren të gjitha masat që kjo çështje të evitohet. Është fjala për një person i cili është me nacionalitet serb, i deklaruar si serb, dhe nuk është mirë që nëse ka ndodhë vërtet ndonjë kërcënim, që nga ana e këtij personi është bërë ndaj tij, dhe nëse është bo ndonjë kërcënim, se unë nuk e di, mirëpo unë kam kërkue nga drejtori i Urbanizmit që seriozisht të merret me këtë çështje. Asfaltimi i rrugës Gllloboqicë-Krushevë nuk është kompetencë e Komunës. Sa i përket peticionit të fshatit Radeshë, peticionin edhe lejen për shfrytëzimin e atij ujit për 15 fshatra, këtë punë e ka bo qeveria e kaluar. Edhe me peticion e ka sigurue që fshati Radeshë pranon që ky ujë të merret në shfrytëzim. Në bazë të këtij peticioni edhe qeveria e kaluar e ka nis projektin e Ujësjellësit. Pas marrjes së pushtetit tonë, nuk e di kush, me qëllim apo pa qëllim, këtë marrëveshje që e ka bo Komuna me fshatin Radeshë, me udhëheqësinë e fshatit Radeshë, ka humb, është hequr nga Komuna dhe është fshehë. Unë po dyshoj se kjo është fshehë me qëllim, që në bashkëpunim me ty, pastaj me e ngrit këtë problem këtu, se gjoja po merret uji aty në mënyrë të dhunshme e pa leje. Por, falë disa qytetarëve të përgjegjshëm, ata na kanë sigurue këtë marrëveshje dhe ne e kemi atë, marrëveshjen të cilën e ka nënshkrue qeveria e kalume bashkë me qytetarët.

Edhe në bazë të asaj marrëveshjeje, ne e kemi vazhduar projektin e Ujësjetës për 15 fshatra. U tha se ana praktike nuk mbahet, nuk është e vërtetë. Ana praktike në shkollën profesionale është duke u mbajtur. Për orët nuk e di, do ta japë përgjigjen drejtori. Por ana praktike është duke u mbajtur, ne jemi duke i transportuar nxënësit në Prizren me autobus, edhe autobusi shkon dy ose tri herë në javë, nuk e di, por mbahet edhe këtu në QKMF. U tha se një qytetar i fshatit Kosavë paska deklaruar në mjetet e informimit, përmes Facebook-it, se unë si kryetar nuk e paskam lejuar Komisionin në vend të ngjarjes. Edhe kjo është një shpifje e atij personi, nuk është e vërtetë. Dje këtë pyetje e ka bërë edhe një anëtar i KPF-së, edhe atij i jam përgjigjur që nuk është e vërtetë. Unë dje e kam thirrur në zyrë kryetarin e Komisionit, ai ka thënë që X personi, i cili ka reagu, nuk ka bërë kërkesë në Komunë që Komisioni të dalë në vend të ngjarjes. Nuk ka kërkesë nga ana e tij, edhe pasi që nuk ka kërkesë, Komisioni nuk ka mujt me pa ëndërr që atij i janë bërë dëme. Ka mundësi që janë bërë, por ai nuk ka bërë kërkesë. Edhe pse unë disa herë në mjete të informimit – në Facebook – kam kërkuar nga qytetarët të paraqiten në Komunë, ta evidentojnë kërkesën e tyre. Sa i përket listës për të riatdhesuarit që kanë marrë ndihma, unë i kam thënë anëtarit të Komitetit që këtë kërkesë të ia bëjë me shkrim Zyrën për Komunitete dhe Kthim. Problemi në fshatin Rrenc, sa i përket Ujësjetës unë e di që aty nuk ka problem, nëse ka do të zgjidhet. Nëse është dëmtuar rruga, ajo do të riparohet dhe do të kthehet në gjendjen e mëparshme. Te varrezat, ekziston problemi, dëmin e ka kompania. Aty do të bëhet një mur mbrojtës, por sivjet nuk mund të bëhet. Sa i përket ndriçimit, është nënshkruar kontrata, është caktuar menaxheri i projektit, edhe mbikëqyrësi i projektit është caktuar, do të fillojë dhe do të përfundojë këtë vit ndriçimi në fshatin Rrenc. U fol edhe për koalicionin VV-LDK, kanë kaluar tri vite dhe nuk duhet me u marrë më me të. Ti i përmende votat, por megjithatë ka qytetarë, votues, anëtarë të VV-së të cilët në rundin e dytë më kanë votuar, gjithashtu edhe në rundin e tretë, kur është votuar jashtë vendit, më kanë votuar, i di edhe jam falënderues. Shumë herë po më përmendet kamera e Zotit, unë kam thënë kamerën e Zotit do ta përdori për punë të mira. Unë, kur më u ka bërë pyetja në Prishtinë, kamerën e Zotit e kam bërë shumë për korrupsion. U tha se me një komision të jashtëligjshëm i kemi zgjedhur drejtorët. Qat Komisionin e jashtëligjshëm e ka bërë Ministria e Arsimit të cilën e udhëheq VV-ja në Prishtinë, nëse është i jashtëligjshëm. Unë nuk po them që është i jashtëligjshëm, po thuesh ti edhe shumë po gabon. Qat Komisionin e ka zgjedhur Kuvendi, e kemi çuar në Ministri, ajo ka thënë që është i ligjshëm. U përmend edhe bashkëshortja e asambleistit, u debatuar shumë për këtë çështje, është politizuar kjo çështje, edhe te Jeta Xharra. Ju keni deklaruar se janë 12 orë, doli që janë 16 e jo 12

orë, keni informue jo drejt. Unë, bashkë me kryesuesen, jemi zotue që do ta zgjidhim problemin edhe të katër orëve tjera, vetëm të kemi thënë bëje kërkesën me shkrim te drejtori në Blaç dhe pastaj ai ia përcjell drejtorit të Arsimit. Drejtori i Arsimit nëse nuk e zgjidh problemin, unë edhe kryesuesja kemi me e zgjidhë këtë problem pa kurrëfarë telashe. Mirëpo, edhe sot e kësaj dite nuk është bo kërkesë. Nëse e ke bo kërkesën, ma bjer ta shoh. Me ligj duhet me bo kërkesë me ta plotësue normën. Sa u përket gropave dhe kodrave, është një gropë, një kodër në rrugën e Brrutit, është. Punëkryesi e ka pranue që ka gabue edhe ka me e përmirësue. Ka me e hek atë dhe me e vu të re. Për dallim prej jush, ne punët që kryhen keq nuk i pranojmë. I shtimë me i bo edhe një herë. Edhe për ata asfaltin te Brruti ku bëtë shumë zhurmë, e kemi shti. Po këtë tjetrën këtut e Rapça, që në 5-6 vende ka rrëshqit toka, e që e ka bo Ministria, pse nuk ke bo zhurmë qaty me i thënë Ministrisë hajde rregulloje. Po ngjajnë këto punë. Unë nuk bëj zhurmë, se kam shumë respekt për zëvendësministrin e Infrastrukturës. Shumë respekt, edhe publikisht po e them. Edhe me video e kam falënderue për kontributin edhe investimet që është duke i bërë në Komunën e Dragashit, sa i përket infrastrukturës rrugore. Unë për atë po them e kam kamerë Zotin, e ti po e përmendish me ironi këtë. Për Klubin futbollistik e pastrimin e lumit, nuk është mirë, tash Muharremi është i ndjerë, edhe e kam pas shok të klasës, edhe e kam pas shok. Kjo që po flitet që ai është largue prej punës, është absolutisht e pavërtetë. Ai deri në vitin 2004 ka punue në Gjimnaz si mësimdhënës. Por, normal, kur është qit konkursi, ky ka qenë i padiplomuar, do të thotë deri në vitin 2004 ka punue si absolvent, ose me dy vjet a tri fakultet, nuk e di. Tash, në vitin 2004, kanë diplomue njerëz tjerë, me fakultet, me diplomë, edhe janë marrë në punë. Kur nuk ka adekuat, merret ai i cili ka diplomë. Me sa e di unë, baba yt ka qenë elektroinxhinier, nuk ka qenë matematicien. Bile – bile, ma shumë di matematikë ekonomisti, sesa elektrikisti. Një asambleist këtu tha se jam shumë i dobët në matematikë. Mirë që e pranoi, se e kam pa edhe para dy seancave që është shumë i dobët, se kur e ka bo mbledhjen, s’di qysh i kanë dalë ato shifra, i kanë dalë 56 mijë a s’di sa. 30 mijë euro me bo gabim, vërtet je dibidus në matematikë, me bo këso gabime. U tha se drejtori i Gjimnazit është zgjedhë me performancë të Ministrisë. Jo! Drejtorit të Gjimnazit peformancën ia mat DKA-ja, e jo Ministria. Nëse nuk beson, merre librin e lexo. E dish cilën libër ti. Sa u përket vërshimeve në Kuk, tash fola unë me Zyrën e Prokurimit, ju e dini që brenda dy javëve e kemi bërë vlerësimin e dëmeve nga infrastruktura. Komisioni Komunal i ka përgatit paramasat dhe parallogaritë, projektet, edhe i kemi çue në Ministri. Kemi kërkue nga Qeveria me na ndihmue, kemi prit dy muaj, nuk na ka ndihmue. Atëherë, jemi detyrue ne me sigurie mjete alternative. Ato

i kemi marrë nga Mallrat dhe Shërbimet, edhe një tender i cili ka qenë i hapur për renovimin e Komunës e kemi anulue, me qato mjete i kemi bo projektet edhe në të njëjtën kohë e kemi shpallë tenderin për Bresanë, Kuk edhe Kosavë. Për fat të keq, kompania e cila e ka fitue tenderin për Kuk, ka qenë 30 mijë euro më e lirë se e dyta, kompania e dytë u ankue në OShP. Ndërsa për punët në Bresanë edhe në Kosavë, kompania nuk u ankue edhe u nënshkrue kontrata. Në Bresanë gati janë krye punimet, tash do të fillojnë, prej nesër, edhe në Kosavë. Nesër përfundon afati i ankesave, edhe nesër ose masnesër ka me u nënshkrue kontrata për Kukin. Për fat të mirë, personi i cili u ankue herën e parë ka dashtë edhe kësaj here me u ankue, po falë njerëzve të cilët kanë bisedue me të, ai u tërheq, sepse nuk ka bazë dhe nuk ka pas bazë edhe herën e parë. OShP-ja e ka kthye prapë, mirëpo në OShP lënda ka qëndrue një muaj. 22 herë e kam thirrë OShP-në për këtë çështjen e Kukit, edhe në fund i kam thënë atij personit kështu: Zoti edhe ti! Ai më ka thënë: Krytear, shumë më ke ngushtue, pas 15 minutave e ka pru Vendimin edhe është zhblllokue procesi. Sa i përket vjeljes së frutave nga qytetarët e Shqipërisë, edhe unë kam qenë shumë i mendimit sikur ti. Me ua ndalue ardhjen e tyre dhe vjeljen e frutave të malit që janë pasuri e jona, mirëpo me vendimin e Qeverisë së Kosovës që të hapet kufiri me Shqipërinë, që ata qytetarë kanë të drejtë të dalin kah të dojnë, të hyjnë kah të dojnë, kam bo një pyetje edhe në MPB, këso vendimi unë nuk kisha të drejtë me marrë. Nuk kishim të drejtë me ua ndalue atyre me ardhë, për arsye se është lëvizje e lirë. Vetëm mundemi që, ato frutat që i mbledhin ata, mos me ua lënë me i qit andej, me i detyrue me i shit këtu. Këtë të drejtë e kishim. Mirëpo edhe diçka tjetër. Kam qenë unë i kam vizitue ato fshatra, kur u ndreq kjo rruga për të cilën Ministria më duket nesër ka me ardhë me e bo përrurimin. Ishalla më thirr mu si zot i shpisë, se herën e kalume nuk më ka thirrë. Unë si kryetar i Komunës duhet me e ditë ministri kur të vjen këtu me e vizitue. Edhe kryeministri, edhe çdokush, kryetari i Komunës normalisht duhet me u njoftue. Normal, ai ka të drejtë me ardhë edhe pa më njoftue, por është rregull edhe kulturë që kryetarin e Komunës me e njoftue që nesër do të vijmë ta bëjmë prerjen e shiritit të asaj rruge. Po nëse nuk më njoftojnë, nuk është problem, nuk është fundi i botës. E përmendet çështjen e “Avokos”, që thatë po e promovon këtë prodhimin e MU-së. Unë s’e kam pa, po nëse e ka bo një gjë të tillë, ka gabue edhe nuk duhet ta bëjë një gjë të tillë. Megjthatë, “Avoko” është OJQ të cilës ne nuk kemi të drejtë me iu përzie. Mirëpo, “Avoko” ka marrë projekte edhe nga Komuna, kështu që një gjë të tillë ajo nuk guxon me e bo. Ajo së pari duhet t’i promovojë prodhimet e Komunës, pastaj edhe të Kosovës. Kurse prodhimet tjera, nuk është mirë, megjithëse MU-ja më duket është e Sllovenisë. Ai nuk e ka shkelë të drejtën ndërkombëtare pse e ka

promovue, mirëpo anën morale e ka shkelë. Unë nuk e di, nashta kam harrue, po nëse kam harrue diçka, drejtori i DKA-së është këtu, ndoshta ka të drejtë edhe dikush tjetër me e marrë fjalën. Faleminderit shumë!

Arijeta Skeraj: Faleminderit! Pasi që nuk ka përmend asnjë emër, atëherë ia kalojmë fjalën drejtorit të Arsimit, e që janë bër shumë pyetje në atë drejtim. Kryetarin e falënderoj që ka qenë deri tash! Tash i vjen një delegacion prej Maqedonisë për një nënshkrim të marrveshjes ndërkufitare. Atëherë, duhet me e kqyrë a kam kuorum, apo s'kam. Atëherë, ju kisha lut mediave, drejtori i Arsimit është në gjendje me ju dhënë përgjigje, ju kisha lut mediave le t'i qesin ku janë të ulur opozita. Tash e lus zyrtarin ligjor të më tregojë nëse ka kuorum! Nuk ka kuorum, e mbyllim këtë seancë! Shihemi në seancën tjetër!